

Seria e Analizave të Politikave e FES 3

Qëndrimet e Partive Kundrejt Shoqërisë:
Vlerat, Religjioni, Shteti dhe Individualiteti



Seria a Analizave të Politikave e FES-it

Raporti për Analizë të Politikave #3: Party
Qëndrimet e Partive Kundrejt Shoqërisë: Vlerat,
Religjioni, Shteti dhe Individualiteti

Përgaditur nga:

Kushtrim Shaipi

Agon Maliqi

Maj, 2009, Prishtinë

**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG

PËRMBAJTJA

1. SFONDI I PROJEKTIT	4
1.1. Arsyetimi	4
2. METODOLOGJIA	5
3. KORRNIZA TEORIKE	7
3.1. Këndvështrimi Teorik: Sistemet e Vlerave dhe Burimet e Zhvillimit të Tyre	7
3.2. Vlerat dhe Politika	9
3.3. Debatet Bashkëkohore për Vlerat dhe Politikën në Perëndim	12
3.4. Vlerat në Kontekst të Politikës Kosovare	14
4. PARTITË E KOSOVËS DHE VLERAT	17
4.1. Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	17
4.2. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).....	20
4.3. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	24
4.4. Aleanca Kosova e Re (AKR)	28
4.5. Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)	32
4.6. Partia Social Demokrate e Kosovës (PSD)	34
5. KONKLUZION	38
SHTOJCA 1: LISTA E TË INTERVISTUARVE	40
SHTOJCA 2: BIBLIOGRAFIA	41

Heqje Përgjegjësie

Këndvështrimet e autorëve të shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht pasqyrojnë ato të Friedrich Ebert Stiftung.

1. SFONDI I PROJEKTIT

IQ Consulting dhe stafi i kësaj kompanie janë angazhuar në fushën e profilizimit të partive politike për më tepër se dy vite. Përvoja e krijuar në këtë drejtim është mjaft e dobishme për akumulimin e njohurive të mangëta akademike dhe empirike në këtë fushë në Kosovë. Dokumentet e krijuara deri më tani janë cilësuar nga shumë akademikë dhe politikanë si një kontribut i tejçmuar që ndihmon evoluimin e mëtutjeshëm të partive karshi zhvillimit të profileve të veçanta ideologjike.

1.1. Arsyetimi

Ky projekt synon të gjenerojë debat në lidhje me çështjet e kontestuara dhe më kontraverse në shoqërinë kosovare. Si i tillë, projekti duhet të stimulojë debate të brendshme në partitë politike dhe në të njejtën kohë, të provokojë reagime të votuesve (duke qenë se për herë të parë vendimet për politika të caktuara do të interpretohen nga këndvështrimi ideologjik). Pasi që procesi i definimit të statusit të Kosovës tanimë është përmbyllur, debatet rreth çështjeve të caktuara pritet të jenë në thelbin e

Ky studim duhet të shikohet si vazhdimësi e punës së deritanishme dhe një stimulim tjetër për profilizimin e partive politike. Përderisa punimet e kaluara në këtë fushë kanë pasur një qasje me të përgjithshme dhe kanë synuar të ofrojnë konceptet bazë të profilizimit për partitë politike dhe studjuesit e shkencave politike, ky projekt synon ndërlidhjen e aspektit teorik të profilizimit me vendim-marrjen dhe politikë-bërjen si dhe me qëndrimet ndaj çështjeve të caktuara.

jetës politike. Përderisa debate të tilla nuk janë promovuar shumë gjatë viteve të fundit me arsyetimin se partitë kanë punë më të rëndësishme—shtetësinë, tanimë nuk duhet të ketë pengesa për debatet mbi përzgjedhjet e politikave. Partitë kryesore në Kosovë janë intervistuar për tema dhe çështje të ndryshme dhe këto intervista kanë shërbyer si bazë për të vlerësuar qëndrimet e partive kundrejt aspekteve të ndryshme të gjykimit moral si dhe çështjeve që tregojnë vlerat e promovuara nga partitë.

2. METODOLOGJIA

Siç është cekur më lartë, projekti ka synuar përdorimin e të gjitha burimeve dytësore të informacionit (raporte të ndryshme, analiza, artikuj nga gazetatat) si dhe informacionit empirik të grumbulluar përmes intervistave të zhvilluara me zyrtarë të partive politike, për të zhvilluar një profil sa më të saktë të partive karshi çështjeve të përmendura. Në këtë mënyrë, projekti synon të ndërlidhë aspektet teorike dhe praktike të profilizimit të partive politike. Arsyeja për një përzgjedhje të tillë të metodologjisë është mungesa e vërejtur e njohurive në anën e praktikuesve të politikës (liderëve dhe anëtarëve) për profilizimin ideologjik të partive politike. Në këtë mënyrë, si liderët e partive ashtu edhe mbështetësit e tyre do të krijojnë një pasqyrë më të saktë të profilit ideologjik. Debatet rreth çështjeve konkrete do të shërbejnë partitë politike të pozicionohen ideologjikisht, një proces ky që deri më tani nuk ka ndodhur në Kosovë. Për më tepër, do t'ju ofrojë atyre një perspektivë më të hollësishme të ideologjive politike duke i përkthyer ato si vendime për politika, aspekt ky që deri më tani nuk është trajtuar sa duhet.

Projekti ka zgjatur për një vit dhe çdo studim është prezantuar në publik. Partitë politike janë vlerësuar në shkallën ideologjike dhe indikatorët e zhvilluar janë përdorur për të

sqaruar pozicionet e partive politike. Këto publikime janë prezantuar në forume të ndryshme duke stimuluar kështu, një debat më të gjerë shoqëror rreth profilizimit ideologjik të partive politike dhe implikimet praktike të këtij profilizimi.

Këto analiza të politikave janë publikuar çdo tre muaj dhe kanë përmbajtur qëndrimet e partive politike mbi çështjet që konsiderohen si të rëndësishme për Kosovën. Projekti është zbatuar në tre cikle identike¹ dhe si rezultat i kësaj janë publikohen tre analiza të politikave të ndryshme. Përderisa raporti i parë i analizës së politikave u fokusua në politikat sociale dhe u titullua “Qëndrimet e Partive Kundrejt Politikave Sociale: *Pensionet, Shëndetësia dhe Privatizimi*”, raporti i dytë u fokusua në analizën e alternativave për zhvillim ekonomik të propozuara nga partitë politike dhe u titullua, “Qëndrimet e Partive Kundrejt Ekonomisë: *Privatizimi, Politikat Fiskale dhe Zhvillimi*”.

¹ Çdo cikël do të mbulohet nga një studim si ky.

3. KORRNIZA TEORIKE

3.1. Këndvështrimi Teorik: Sistemet e Vlerave dhe Burimet e Zhvillimit të Tyre

Fjala “vlerë” është mjaft abstrakte. Në përgjithësi ajo i referohet besimeve të caktuara subjektive të një personi të cilat janë pjesë e një “sistemi vlerash”. Vlerat janë kornizat e thella mendore të cilat përdoren nga individët dhe shoqëritë për të dalluar të mirën dhe të keqën. Në këtë kontekst, ato janë të afërta dhe shpesh identike me *moralitetin* apo *etikën*. Vlerat luajnë rol edhe në sjellje. Një person tregon tendencë që ti shpreh vlerat e tij/saj në publik dhe potencialisht ti bashkohet të tjerëve që ndajnë të njëjtat bindje, në rastin e fundit edhe në formën e veprimit politik. Vlerat janë të afërta edhe me normat shoqërore. Megjithatë, këto të fundit më shumë u referohen sjelljeve shoqërisht të pranueshme, ndersa vlerat janë më tepër gjykime të bëra ndaj këtyre sjelljeve. Se a janë këto gjykime pozitive apo negative, kjo varet nga mënyra se cilat janë normat e individit i cili e bën gjykimin.

Individë dhe parti të ndryshme politike kanë sisteme të ndryshme vlerash. Disa mund t'i japin theks më shumë vlerave kulturore ose kombëtare, disa të tjerë parimeve fetare ose ideologjive të tjera doktrinare. Çfarë e definojnë zgjedhjen e vlerave të tyre? Nëse përdorim fjalët e filozofit spanjoll Jose Ortega y Gasset do

të thoshim se njeriu është prodhim *i egos* dhe *rrethanave* të tij. Andaj, mund të sugjerojmë se zhvillimi i sistemeve të vlerave përcaktohet nga një kombinim faktorësh të lidhur me karakterin e individit dhe kontekstin e ekzistencës së tij në shoqëri.

Koncepti i vlerave është studiuar thellësisht në psikologji. Gjëja e parë që mbase vlen për tu theksuar në këtë aspekt është se individët tregojnë tendencë të fortë psikologjike për tu dhënë gjërave dhe fenomeneve abstrakte një vlerë të brendshme dhe thelbësore. Nevoja për kornizë mendore të bazuar në moral dhe vlera duket të jetë diçka e ngulitur brenda nesh. Por ama, përse njerëz të ndryshëm konsiderojnë gjëra të ndryshme si të rëndësishme? Shumë prej vlerave që ne i çmojmë si të rëndësishme përcaktohen nga trajtat psikologjike të individit. Për shembull, një individ që ka tendencë psikike për të treguar mirëkuptim ndaj njerëzve të tjerë është më i prirur që ta çmojë bamirësinë. Kjo në kontekst politik do të thoshte tendencë më të madhe për të mbështetur politika të mirëqenies që synojnë tu ndihmojnë kategorive më të brishta shoqërore.

Psikologët kognitivë si Jean Peaget dhe Laërence Kohlberg kanë zhvilluar teori të cilat tregojnë se si vlerat zhvillohen gjatë etapave të ndryshme të jetës së një individi si rezultat i marrëdhënies mes trajtave psikike të individit me përvojat e tij gjatë rritjes.² Kjo qasje më konstruktiviste sugjeron se vlerat tona përcaktohen edhe nga ambienti ynë i jashtëm dhe nga përvojat tona. Do të ishte e natyrshme po ta merrnim parasysh në këtë pikë se si faktorët demografik ndikojnë në krijimin e vlerave tona. Për shembull, duket qartë se preferenca ndaj principeve konservative është më e dukshme në shoqëri ku komunitetet janë më ngushtë të lidhura në mes vete dhe janë më homogjene (qyteza të vogla provinciale, zona rurale), ndërsa vlerat kozmopolite dhe liberale janë më të spikatura në komunitete heterogjene dhe të llojllojshme (qytetet e mëdha). Gjërat të cilat kanë vlerë thelbësore për individin janë ato të cilat kanë vlerë në njësitë e ndryshme shoqërore dhe ligjërimet në të cilat ky individ bën pjesë, duke përfshirë këtu familjen, kombin, frymën e gjeneratës, etj.

Një këndvështrim interesant në përshkrimin e natyrës psikike të zhvillimit të vlerave është analiza nga perspektiva e faktorëve motivues. Psikologu Shalom Schëartz e ofron një sistem të

integruar të sistemeve të vlerave të cilat bashkohen me njëra tjetrën në formë qarkore dhe i reflektojnë katër tipe të ndryshme të orientimeve motivuese. Schëartz e shpjegon sistemin duke thënë se “natyra e përputhshmërive në mes të llojeve të ndryshme të vlerave sqarohet duke vënë re orientimet e ngjashme të vlerave që puthiten me njëra tjetrën. Të vështruara sipas këtyre orientimeve të ndara, llojet e puthitura përbëjnë një vazhdimësi motivuese rreth strukturës qarkore të vlerave. Ndërkaq, synimet motivuese që vihen përballë njëra tjetrës janë kundërtëse dhe nuk mund të ndiqen njëkohësisht.”³




FIG. 1.1. The prototypical structure of value systems.

² Crain W.C, Teoritë e Zhvillimit, Kapitulli VII. “Format e Kohlbergut mbi Zhvillimin Moral” pp-118-136, Prentice-Hall, 1985

³ Shwartz, Shalom. “Prioritetet e Vlerave dhe Sjellja: Zbatimi i Teorisë për Sistemin e Integruar të Vlerave”. Kapitull në librin: “Psikologjia dhe Vlerat”. Edituar nga Clive Seligman, James Olson dhe Mark P. Zanna. Routledge, 1996.

Faktorët motivues të përshkruar në këtë figurë mund të shërbejnë si bazë e mirë për kuptimin e vlerave të aktorëve politik dhe për parashikimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre. Për shembull, ata individë që motivohen nga konservimi dhe që mbështesin vlerat si siguria, tradita dhe konformizmi do të bëjnë përpjekje që status kuo-ja e shoqërisë së tyre të ruhet, dhe për ta arritur këtë synim ata do të bashkohen me individë të tjerë që ndajnë të njëjtat vlera. Disa nga këta individ do të motivohen edhe nga dëshira për rritje personale (self-enhancement) – duke çmuar fuqinë dhe arritjet personale – dhe si rezultat do të dalin në ballë të atyre me të cilët ndajnë vlera të përbashkëta.

Por cilat janë vlerat të cilat konservuesit dëshirojnë ti ruajnë? Ato dallojnë në varësi të kontekstit socio-politik të një shoqërie. Në

shumicën e rasteve kjo do të nënkuptonte traditat kombëtare, fetare ose ideologjike. Në një shoqëri të caktuar, një numër i madh individësh mund të mendojë se elemente të caktuara të kulturës kombëtare, si për shembull gjuha, muzika, zakonet e sjelljes, janë vlerë e cila duhet ruajtur. Në po të njëjtën shoqëri, ata që motivohen nga hedonizmi, stimulimi dhe pavarësia në vazhdimësi do ta sfidojnë vlefshmërinë e këtyre vlerave tradicionale dhe do të veprojnë në kundërshtim me to. Për këtë arsye, në strukturën e sistemeve të vlerave të zhvilluara nga Schwartz, kategoritë motivuese kundërtëne të emëruara si “hapje ndaj ndryshimit” dhe “konservim” janë vendosur përballë njëra tjetrës.

3.2. Vlerat dhe Politika

Politika është mekanizmi përmes të cilit vlerat e individëve garojnë në nivel më të gjerë shoqëror. Siç u tha më lart, individët me vlera të ndryshme i gjejnë disa nga vlerat e tyre të përfaqësuara në agjendat e partive dhe lëvizjeve të caktuara politike. Një gjë që vlen për tu theksuar në këtë pikë është se një demokraci liberale e kohëve moderne kërkon konsensus të shoqërisë në të paktën disa vlera bazike

fundamentale të cilat do ta bënin të mundur pluralizmin e vlerave. Në këtë aspekt, mund të thuhet se besimi në demokracinë kushtetuese është vlera më themelore konsensuale e një demokracie të pjekur. Filozofi i ndjerë Richard Rorty e sugjeron këtë gjë kur deklaron se, përkundër botëkuptimeve të tyre krejtësisht të kundërta, “e majtë ekstreme e partisë demokratike dhe e djathta ekstreme e partisë

republikane janë njëloj të dedikuara për ta mbrojtur kushtetutën e SHBA-ve”⁴ Përkundër faktit se të dyja palët mund të kenë mospajtime për pjesë të ndryshme të kushtetutës apo mund ta interpretojnë atë në mënyra të ndryshme, dhe përkundër mospajtimeve të tyre të thella në vlera themelore, mbështetësit e njërës parti e pranojnë rezultatin e zgjedhjeve edhe nëse partia tjetër i fiton zgjedhjet. Këtë e bëjnë sepse kanë besim në vlerën e rendit kushtetues.

Në shkencat politike, vlerat shihen si një nga elementet më të rëndësishme në definimin e qëndrimeve dhe sjelljeve politike. Vlerat shihen si “tullat mbi të cilat konstruktet psikologjike më pak rezistuese si qëndrimet dhe opinionet formohen dhe mirëmbahen”⁵. Në shkencat politike ato gjithashtu “në mënyrë standarde konceptohen si më të thella, më të qëndrueshme dhe i paraprijnë preferencave politike që lidhen me çështjet dhe vlerësimet e kandidatëve”⁶. Politikologu Zaller deklaroi se “çdo mendim është prodhim i kombinimit të informatës me vlerat – informatat gjenerojnë një fotografi mendore për çështjen në fjalë,

ndërsa vlerat e gjenerojnë gjykimin për këtë çështje”⁷.

Politikologët kanë vënë theksin te rëndësia e *vlerave bazike* si elementi më thelbësor në parashikimin e zgjedhjes votuese të individëve në zgjedhje. Supozimi kryesor është se këto vlera kanë stabilitet afatgjatë dhe mund të rezistojnë ndryshimeve. Po t’ju rikthehemi motiveve orientuese të prezantuara nga Shëartz, me lehtësi do të supozonim se një person i cili motivohet nga konservimi me gjasë do të votonte për një parti konservatore. Megjithatë, studimet në shkencat politike kanë treguar se vlerat janë faktor fleksibil sepse ato pjesërisht ndërtohen nga përvojat e jashtme. Një seri ngjarjesh mund të shkaktojnë që një person të ndryshojë mendje për gjëra të ndryshme. Për shembull, një individ i ri dhe liberal i cili motivohet nga hapja mund të bëhet më konservativ kur rritet në moshë, një fenomen që mbase ilustron më së miri nga citati i famshëm i Winston Churchill: “Ma trego një konservativ të ri, dhe unë ta tregoj një njeri pa zemër. Ma trego një liberal të vjetër, dhe unë ta tregoj një njeri pa tru”.

⁴ Rorty, Richard. “Demokracia dhe Filozofia”: Ligjerata gjendet në faqen e internetit: <http://www.eurozine.com/articles/2007-06-11-rorty-en.html>.

⁵ Sturgis, Patrick. “Afërsia me Parti dhe Ndryshimi i Vlerave Themelore Politike” – Këshilli Hulumtues Ekonomik dhe Social, Dokument Pune nr. 5

⁶ Sturgis, Patrick. “Shkaqet dhe Pasojat e Vlerave Politike Bazë” – Punim i prezantuar në takimin vjetor të Ahoqatës Amerikane për Shkenca Politike. 27 gusht, 2003

⁷ Sturgis, Patrick. “Afërsia me Parti dhe Ndryshimi i Vlerave Themelore Politike” – Këshilli Hulumtues Ekonomik dhe Social, Dokument Pune nr. 5

Vlerat bazike janë debatuar në mes të përkrahësve të ideologjive politike që nga zhvillimi i tyre në epokën moderne. Revolucionet politike moderne që filluan në Evropë gjatë Shekullit XVIII shënuan fundin e një periudhë shumë-shekullore të absolutizmit moral në të cilën vlerat e një shoqërie përcaktoheshin nga Kisha Katolike. Paraqitja e Protestantizmit dhe më vonë e filozofive politike normative (liberalizmi klasik, socializmi, konservatizmi, nacionalizmi, etj) e krijuan një situatë të vlerave konkurruese të cilat nuk e legjitimonin veten detyrimisht me argumente hyjnore, por kryesisht nga etika sekulare. Përderisa më parë vlerat e një jete të mirë përcaktoheshin nga Kisha dhe Mbretërit, si sovranët “e legjitimuar nga hyjnitë”, tani ato përcaktoheshin nga parime si “liria, barazia dhe vëllazëria” (Revolucion Francez) apo “jeta, liria dhe ndjekja e lumturisë” (Revolucioni Amerikan), ndërsa sovrani ishte elektorati.

Liberalët klasik si John Locke dhe John Stuart Mill ishin ndër të parët që eliminuan nevojën për absolutizëm moral në domenin ligjor të shtetit. Pikërisht për këtë arsye kushtetutat e para demokratike panë nevojën për ta ndarë shtetin nga kisha. Filozofët liberal argumentuan asokohe, dhe vazhdojnë të argumentojnë edhe sot, se roli i shtetit është që t’i mundësojë dhe ti mbrojë liritë dhe të drejtat e individuale, dhe jo që t’ua kufizojë ato në emër të ndonjë vlere që

në mënyrë arbitrare deklarohet si superiore. Themelet e këtij mendimi bazohen në epistemologjinë përgjithësisht më pragmatike dhe relativiste të liberalëve të cilët deklarojnë se nuk mund të flitet për vlera universale dhe të gjithëkohshme, por vetëm për një pluralitet vlerash të cilat mund të jenë njëkohësisht korrekte. Filozofi politik Isaiah Berlin më vonë e quajti këtë qasje si “pluralizëm vlerash”⁸.

Në anën tjetër, teoria politike konservative lindi si reagim ndaj revolucionit demokratik në Francë dhe qasjes relativiste të liberalizmit mbi vlerat shoqërore. Për mendimtarët konservativë si Edmund Burke, baza morale për qeverisje nuk mund të burojë nga logjika abstrakte e ideve të iluminizmit, por vetëm nga njohuritë e trashëguara përmes institucioneve tradicionale si familja dhe kisha. Në themel, mendimi konservativ dominohet nga një botëkuptim platonist dhe nga besimi në ekzistencën e vlerave universale dhe të gjithëkohshme. Konservatorët menduan se këto vlera po rrezikoheshin nga revolucioni francez. Vazhdimësia e këtij mendimi është e dukshme në shekullin njëzet për shembull te mendimtarët si Leo Strauss dhe neo-konservatorët e sotëm në SHBA.

Ideologjia politike marksiste gjithashtu ishte zhvilluar si reagim i punëtorëve dhe klasave të

⁸ Berlin, Isaiah (1969). Katër Ese Mbi Lirinë. Oxford University Press.

shtypura ndaj premtimeve të papërbushura të revolucioneve demokratike – kryesisht ndaj premtimit për barazi. Për punëtorët dhe intelektualët marksistë, barazia shihet si vlera kryesore politike. Në këtë mënyrë, marksizmi bëhet kundërshtar edhe i liberalizmit edhe i konservatizmit sepse të dyja këto filozofi politike në sferën ekonomike i mbronin interesat e borgjezisë së re dominuese si dhe elitave tradicionale. Ajo që Marksizmi si filozofi kishte të përbashkët me konservatizmin ishte kundërshtimi i “pluralizmit të vlerave” të promovuar nga liberalizmi, pra të dyja e ndanin një pikëpamje platonike të historisë. Dallimi ishte se pikëpamjet progresive Marksiste mbi

botën e drejtë morale ishin krejtësisht të kundërta me konservatizmin tradicional.

Paraqitja e nacionalizmit gjatë revolucionit industrial e krijoi një vlerë të re në Evropë që nuk kishte ekzistuar më parë: vlerën e identitetit kombëtar. Shpirti i romanticizmit dhe idealizmit bëri që qytetarët e shteteve evropiane për herë të parë të ishin të gatshëm të sakrifikoreshin në emër të kombit, një kategori abstrakte që e definonte grupin etnik apo kulturor në të cilin ata bënin pjesë. Mbrojtja e kombit, një njësi që konsiderohej se kishte rrënjë historike dhe një të ardhme të projektuar të përbashkët, filloi të konsiderohej si një vlerë në vetvete.

3.3. Debatet Bashkëkohore për Vlerat dhe Politikën në Perëndim

Që nga konceptimi klasik i tyre, doktrinat kryesore politike të modernitetit kanë evoluar dhe janë përzier në mes vete në mënyra të ndryshme. Vargu i çështjeve morale me të cilat ato ballafaqohen sot është më i llojlojshëm. Megjithatë, në nivel fundamental, disa parime bazike kanë mbetur të njëjta në pothuajse çdo shoqëri të zhvilluar demokratike. Nëse në të kaluarën debati në mes të konservatorëve dhe liberalëve mund të jetë bërë mbi rolin e kishës në shtet, sot debati shtrohet në nivel të çështjeve të tjera si për shembull roli i shtetit në kufizimin e të drejtave të individit në raport me

homoseksualizmin, abortin, etj. Paralele të ngjashme mund të vihen edhe për debatet në mes të ideologjive të tjera. Por pa marrë parasysh se sa të ndryshme janë këto debate sot, ato në thelb janë një reflektim i disa vlerave themelore me burim në ideologjitë klasike.

Për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sot mund të vërehet se sa rol të madh luajnë vlerat fetare në përcaktimin e preferencave politike të votuesve. Për ta ilustruar këtë, mjafton të përmendet fakti se shumica e amerikanëve nuk do ta votonin një

ateist për president të vendit, edhe nëse ai do të ishte i kualifikuar për këtë pozitë.⁹ Supozimi këtu është se një ateist nuk do të kishte të përbashkët me këta votues diçka që ata e konsiderojnë si shumë të vlefshme – pra, besimin në zot – dhe si rezultat nuk do ndiqte politika që përkohë me vlerat e tyre. Kjo edhe njëherë ilustron faktin se vlerat kulturore janë faktorë përcaktues në preferencat votuese, të shumtën e kohës edhe më tepër se interesat e drejtpërdrejta ekonomike të votuesve. Dihet për shembull se si pikëpamjet fetare për çështjet si aborti, martesë homoseksuale apo futja në planprogramet shkollorë të “teorisë krishtere të krijimit të njerëzimit”, luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin e votës së një individi fetar. Për këta votues, qëndrimet e kandidatëve politik mbi këto çështje janë më të rëndësishme sesa qëndrimet për politikën ekonomike sepse ata u japin prioritet ruajtjes së vlerave kulturore.

Votuesit të cilët motivohen nga dëshira për konservim gjithashtu mund të kundërshtojnë politika të tjera të cilat i shohin si kërcënim për identitetin kulturor të shoqërisë së tyre – për shembull imigracioni ose politikën e cilat

promovojnë multikulturalizëm. Përkundër faktit se imigracioni ka pasur ndikim pozitiv ekonomik në Shtetet e Bashkuara dhe në Bashkimin Europian, duke u ofruar këtyre dy vendeve fuqi të nevojshme punëtore, në këto shtete megjithatë është vënë re rritja e mllefrit kundër imigrantëve dhe rritja e votës për parti të së djathtës ekstreme në disa vende të BE-së. Segmentet shoqërore të cilat i mbështesin këto parti nuk i shohin imigrantët thjesht si “njësi ekonomike”, por kryesisht si kërcënim për “pastërtinë” e identitetit të tyre kulturor dhe kombëtar, ose siç thuhet shpesh, “mënyrës së tyre të jetesës”.

Megjithatë, votuesit të cilët nuk janë konservativ mund të jenë mbështetës të politikave të migrimit, abortit apo martesës së homoseksualëve sepse sistemet e tyre të vlerave janë të ndryshme dhe, sipas strukturës së Shwartz, ata janë të motivuar nga vetë-përsosshmëria dhe hapja ndaj ndryshimit. Për shembull, edhe nëse këta individ e respektojnë kulturën dhe identitetin e tyre kombëtar, një segment i tyre mund të ketë shpirt bamirësie dhe do të ketë mirëkuptim më të madh për vështirësitë me të cilat ballafaqohen imigrantët, prandaj edhe do të mbështesin të drejtat e tyre. Një segment votuesish mund të kundërshtojë çfarëdo koncepti të absolutizmit moral dhe të çmojë lirinë e individit për të zgjedhur stilin e

⁹Jones, M. Jeffry. Disa Amerikanë Hezitojnë të Votojnë për Mormonë, Kandidatët Presidential 72-Vjeçarë. Artikull që gjendet në faqen e internetit: <http://www.gallup.com/poll/26611/Some-Americans-Reluctant-Vote-Mormon-72YearOld-Presidential-Candidates.aspx>.

vet të jetesës dhe marrjes së vendimeve vetanake për çështje morale.

Në skenën bashkëkohore politike të hemisferës perëndimore gjatë dekadave të fundit kemi vënë re daljen në skenë të lëvizjeve politike që merren me çështje specifike, si psh *lëvizjet për të drejtat e njeriut* apo *lëvizjet e gjelbërta*. Vetëdija shoqërore për këto çështje ka krijuar segmente shoqërore të votuesve apo blloqe votuesish vlerat e të cilëve përcaktohen nga mbështetja për të drejtat e njeriut apo ambientalizmin. Për shembull, një votues “i

gjelbër” në SHBA me gjasë do të votonte për kandidatët e Partisë Demokratike sepse kjo e fundit është mbështetëse më e madhe e nismave “të blerta”. Megjithatë, disa nga votuesit mjedisor mund të vijnë nga rrethe shoqërore konservative dhe të mos kenë vlera të tjera të përbashkëta me partinë demokratike – siç janë për shembull të drejtat individuale që shkojnë kundër parimeve fetare. Për këtë lloj qytetarësh, vendimi i votimit me siguri do të merrej pasi që do të viheshin në peshore vlerat sipas prioritetit personal.

3.4. Vlerat në Kontekst të Politikës Kosovare

Në demokracitë e brishta si ato të Evropës Juglindore, debatet e ideologjive klasike zakonisht kombinohen apo mbizotërohen krejtësisht nga problemet specifike që kanë lindur si rezultat i tranzicioneve politike nga autoritarizmi, kolonializmi, konfliktet etnike, etj. Si rezultat, natyra e debateve politike në këto shoqëri dallon shumë prej debateve që bëhen në një demokraci tipike perëndimore, ku këto probleme janë tejkaluar prej kohësh. Në Kosovë sot mund të vihet re se vonesat në procesin e modernizmit të shoqërisë bëjnë që mjedisi politik të jetë pothuajse para-modern – një mjedis politik në të cilin legjitimiteti politik buron kryesisht nga sistemi i patronazhit dhe besnikëria ndaj fisit apo edhe tërheqja ndaj narracioneve irracionale mitologjike.

Deri më sot nuk është bërë ndonjë studim i gjerë për ti kuptuar dhe kategorizuar vlerat të cilat votuesit kosovar i konsiderojnë si më të rëndësishme. Megjithatë, një analizë dhe kategorizim ad-hoc do të mund të bëhej në bazë të një vëzhgimi të thjeshtë të trendeve në sjelljen e votuesve dhe në ligjërimin publik politik. Gjëja e parë që duhet theksuar në këtë drejtim është se shoqëria kosovare është thellësisht konservative. Kjo ndodh për arsye strukturore: Kosova është vend kryesisht rural në të cilin proceset modernizuese si urbanizimi apo industrializimi kanë ndodhur me vonesë të konsiderueshme – madje edhe në krahasim me rajonin – dhe po e arrijnë klimaksin vetëm kohëve të fundit. Për shkak të kësaj, mendësia e shoqërisë është thellësisht e lidhur me vlerat

kulturore të jetesës paramoderne dhe rurale. Ky parapëlqim për traditën është thelluar sidomos gjatë rezistencës ndaj Serbisë.

Mund të thuhet pra se, në nivel makro, pjesa më e madhe e elektoratit kosovar e konsideron identitetin kombëtar, dhe një varg vlerash tradicionale kulturore që ndërlidhen me këtë identitet, si një gjë me vlerë themelore. Ky besim e shpjegon një ndër shumë ndasitë në perceptimin e votuesve për partitë politike dhe kandidatët që garojnë në zgjedhje. Në këtë kontekst, një parti politike e cila ka portret më kozmopolit dhe urban, detyrimisht do të shihet si më kërcënuese ndaj vlerave tradicionale kombëtare dhe me të shumica e votuesve nuk do të ndiejnë afërsi. Mund të thuhet se kjo ka qenë një ndër shkaqet për skepticizmin e votuesve kosovarë ndaj partisë politike ORA – një parti e përbërë kryesisht nga intelektualë më kozmopolit.

Brenda spektrit të partive që shihen brenda “projektit kombëtar”, ndasia kryesore në skenën politike të pas vitit 1999 në Kosovë ishte ajo në mes të “krahut paqësor” të udhëhequr nga LDK-ja e Ibrahim Rugovës dhe “krahut të luftës” të përbërë nga partitë e udhëhequra nga ish-komandantët e UÇK-së. Besnikëria e votuesve ndaj këtyre partive nuk kishte asgjë të bënte me agjendat e tyre ideologjike në politikat publike, por thjesht me bëmat e tyre

gjatë betejës së gjatë për pavarësi nga Serbia. Në ligjërimin politik publik, përkrahësit e “krahut të luftës” vazhdimisht flisnin për respektin e tyre për “vlerat e luftës” – ndërkohë që sipas tyre ata që kishin marrë pushkën kundër Serbisë (pra ata që përfaqësojnë vlerat e luftës) tani kishin legjitimitet politik të qeverisnin me Kosovën e lirë. Në anën tjetër, shumica e mbështetësve të Ibrahim Rugovës vazhdimisht flisnin për të dhe vizionin e tij në dimension mitologjik, duke i dhënë atij një “legjitimitet hyjnor” pothuajse të afërt me monarkët para-modern European.

Natyra e thellë e këtyre ndasive sot është zbutur, sidomos pas koalicioneve LDK-AAK dhe tani LDK-PDK, por besnikëria e votuesve qëndron akoma. Me kalimin e kohës, zbrazëtia ideologjike e këtyre lidhjeve të votuesve me partitë e zbuloi edhe një arsye tjetër për këtë besnikëri të votuesve – bëhet fjale për vlerën që votuesit i japin *përkatësisë rajonale* të kandidatëve politik dhe partive. Kjo cilësi jep një nga indikacionet më të forta për natyrën jo-ideologjike dhe qenësisht paramoderne të politikës kosovare. Për shembull, për votuesit në fshatrat dhe qytezat e vogla të Dukagjinit dhe Drenicës, fakti se udhëheqësit e AAK-së dhe PDK-së vijnë nga rajoni i tyre është vlerë në vetvete – dhe kjo përkundër faktit se mund të ketë faktor të tjerë racional që mund të merren parasysh gjatë marrjes së vendimit për të

votuar. Natyrisht, kjo mbështetje fisnore e votuesve për një parti politike zakonisht shoqërohet me perceptimin se fitorja e kësaj partie do të sillte përfitime praktike përmes sistemit të patronazhit, siç mund të jetë për shembull zënia e një vendi të punës.

Instalimi i një sistemi liberal demokratik të bazuar në ekonomi të tregut tani ka filluar ta sjell Kosovën më afër ndasive klasike shoqërore dhe klasore të një demokracie perëndimore. Gjatë viteve të fundit janë thelluar dallimet në të ardhura mes një elite të re të biznesit dhe politikës në njërën anë, dhe punëtorëve të thjeshtë apo të papunëve në anën tjetër. Kjo çdo ditë e më tepër do të sjell vlerat si *solidariteti* apo *drejtësia sociale* në qendër të diskursit politik dhe do t'u jap rast partive të majta që të joshin segmente votuesish që i ndajnë këto vlera. Faktorët ekonomik gradualisht do të çojnë deri te një rirreshtim i skenës politike më shumë drejt dallimeve klasike majtë – djathtë.

Në politikë, diskutimet për vlerat dalin në sipërfaqe sidomos pas rasteve kontraverse në të cilat zgjedhjet individuale të qytetarëve janë në kundërshtim me normat standarde shoqërore që burojnë nga tradita të ndryshme (identitete kombëtare, fe, etj). Ekziston një dimension i thellë politik në faktin se individët nuk mund të bëjnë gjëra të caktuara në sferën e

tyre private meqë në këtë gjë do t'ju ndërhyjnë shoqëria dhe shteti. Në këtë kontekst, Kosova e ka një kushtetutë shumë bashkëkohore dhe kornizë ligjore shumë liberale sa i përket të drejtave të njeriut. Megjithatë, ekziston një mospërputhje e madhe në mes të kushtetutës liberale dhe vlerave konservative që dominojnë shoqërinë. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të prezencës ndërkombëtare në Kosovë dhe mënyrës se si janë shkruar dhe aprovuar ligjet gjatë viteve të fundit – pra, sipas sistemit lartë poshtë.

Përkundër të drejtave ligjore, nëse një individ në Kosovë bën diçka që shkon kundër traditave të shoqërisë, zakonisht shfaqet ankesa se kjo është “kundër vlerave tona”. Ta marrim për shembull çështjen e homoseksualitetit, një fenomen që nga shumica dërmuese e popullsisë së Kosovës shihet si diçka krejtësisht e papranueshme dhe kundër vlerave tradicionale. Kushtetuta e Kosovës megjithatë garanton mbrojtjen ndaj diskriminimit në bazë të orientimit seksual. Partitë politike në Kosovë deri më sot nuk kanë marrë kurrfarë pozicionesh konkrete në raste të tilla sepse vendi është aq konservativ sa që këto çështje rrallë edhe diskutohen. Sa i përket çështjeve të tjera kontraverse si psh. legalizimi i drogave të lehta, legjislacioni është në përputhje me mentalitetin shoqëror për shkak se i ndalon ato. Në përfundim, partitë liberale ose libertariene

do të promovonin ose zbutjen e dënimeve për posedimin e këtyre drogave ose legalizimin e plotë të disa prej tyre. Por këto tema në Kosovë nuk janë pjesë e diskursit politik.

Shoqëria kosovare është kryesisht sekulare, por ekzistojnë segmente të saj që në shkallë të ndryshme janë fetare. Në rastet më ekstreme këta votues fetar mendojnë se partitë duhet të promovojnë ose të qeverisin në përputhje me vlerat shoqërore. Vetëm një parti politike deri më tani e ka promovuar një diskurs më fetar – Partia e Drejtësisë – por ajo nuk ka arritur ta

kalojë prapë në zgjedhjet e kaluara parlamentare. Në demokracitë perëndimore, partitë fetare kristiane janë zakonisht ato që i politizojnë çështjet e zgjedhjes individuale për *abortion* apo *eutanazinë*. Në Kosovë, roli i vogël i fesë në politikë ka bërë që këto çështje të mos zënë vend të rëndësishëm në ligjërimin politik. Për shembull, legjislacioni që lejon *abortion* është kaluar nga Parlamenti i Kosovës pa ndonjë pengesë apo kundërshtim serioz nga ana e opozitës apo e cilësdo parti të rëndësishme politike.

4. PARTITË E KOSOVËS DHE VLERAT

4.1. Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Përfaqësuesit e intervistuar për këtë hulumtim ishin Z. Xhavit Haliti Anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe Z. Memli Krasniqi, Deputet dhe Zëdhënës i Qeverisë së Kosovës. Të dy të intervistuarit e PDK-së theksojnë se përkrahin vlerat themelore të cilat përfshijnë të drejtat individuale dhe grupe (të komuniteteve), zvogëlimin e varfërisë, barazinë gjinore, zhvillimin e ekonomisë së tregut, integrimin Europian dhe demokracinë midis tjerash. Mendimet e Z. Haliti dhe Z. Krasniqi janë paksa të ndryshme kur është fjala për këto vlera dhe për mënyrën se si përcaktohen ato. Derisa njëri thekson se ka pasur diskutime të pastrukturuara për këto vlera në bazën e

anëtarësisë por se vendimin përfundimtar e ka marrë kryesia e partisë, tjetri thekson se nuk ka ndonjë vendim formal të partisë dhe se këto vlera janë rezultat i origjinës dhe traditës së saj.

Sipas Z. Haliti, vlerat e përqafuara nga PDK nuk janë shumë të rëndësishme për elektoratin, pasii që ai beson se votuesit nuk janë të informuar për sistemin e vlerave të PDK-së. Në anën tjetër, Z. Krasniqi thekson se votuesit janë shumë mirë të informuar për vlerat, programet dhe platformat e PDK-së dhe se kjo është si rrjedhojë e interaksionit të vazhdueshëm midis votuesve të partisë dhe të gjithë atyre që asociohen me partinë. Më tutje, dy

përfaqësuesit gjithashtu nuk pajtohen me njëri tjetrin për raportin midis vlerave të partisë dhe votimit në Kuvendin e Kosovës. Derisa njëri beson se këto të dyja paraqesin një kompromis me njëra tjetrën dhe se kjo ndodh për shkak të debatit të pamjaftueshëm në Kuvend, përfaqësuesi tjetër beson se qëndrimet e shprehura nëpërmes votimit janë pak a shumë në përputhje me vlerat e partisë.

Në pyetjen se si do të radhitnin rëndësinë e individit kundrejt grupit/shoqërisë, të dy përfaqësuesit e PDK-së theksojnë që individi ka autoritet/(supremaci) në shkallën e tyre të vlerave. Ky qëndrim argumentohet me pozicionin e përgjithshëm të partisë mbi të drejtat dhe liritë e garantuara të individëve, përfshirjen e tyre aktive në shoqëri dhe ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë individët. Një shtet i tillë sipas përfaqësuesve të PDK-së duhet të jetë jo-fetar dhe se religjioni duhet të jetë plotësisht e ndarë nga shteti. Megjithatë, duhet të përmendet se PDK shpreh që pavarësisht sekularizmit të shtetit, mbrohet dhe përkrahet e drejta e besimit. Në të njëjtën temë, të dy përfaqësuesit e PDK-së theksojnë se feja nuk duhet të përfshihet në arsimin publik. Megjithatë, njëri nga të intervistuarit thekson se partia nuk ka qëndrim zyrtar rreth kësaj çështjeje.

Për sa i përket abortit, që është edhe një çështje që në vende të ndryshme është zakonisht e lidhur me qëndrimet e partisë për fenë dhe me ndikimin e grupeve fetare, që të dy të intervistuarit e PDK-së pajtohen se ajo duhet të jetë e ligjshme, por që duhet të kontrollohet nga afër në mënyrë që të mos ketë keqpërdorime. Përkundër qëdrimeve uniforme për abortin, anëtarët e parlamentit nuk pajtohen rreth kohës se deri kur duhet të lejohet një gjë e tillë. Derisa njëri prej tyre beson se ligji aktual është shumë liberal dhe se aborti duhet të jetë lejuar deri në gjashtë javë prej momentit të ngjizjes, i intervistuari tjetër beson se periudha aktuale prej dhjetë javësh është kufiri më optimal për lejim të abortit.

Ndryshe nga aborti, deputetët e PDK-së në Kuvend nuk kanë mendim të përbashkët rreth eutanazisë. Derisa njëri thekson se nuk ka kuptim që një person të mbahet artificialisht në jetë, anëtar i tjetër i PDK-së në Kuvend thekson se e drejta e jetës është e garantuar me ligj derisa e drejta për të vdekur nuk është, duke theksuar në këtë mënyrë qëndrimin e tij negativ për aplikimin e eutanazisë.

Homoseksualiteti është edhe një çështje për të cilën u kërkua që partitë të deklaroreshin dhe pozicionoheshin. Derisa njëri nga të intervistuarit beson se e drejta për tu martuar duhet t'i takojë secilit që dëshiron ta shfrytëzojë

atë, pavarësisht nga orientimi seksual, përfaqësuesi tjetër beson se një gjë e tillë nuk duhet të lejohet në Kosovë. Mospajtueshmëria nga njëri pozicion tek tjetri me ç'rast njëri thekson se martesë e homoseksualeve duhet të lejohet dhe tjetri i cili pozicionohet aq larg sa thekson se provizionet kushtetuese nuk e lejojnë konkretisht këtë¹⁰ është një shenjë që tregon se nuk ka pasur dialog të mjaftueshëm në nivelin partiak dhe nuk ka ndonjë konsensus partiak sa i përket kësaj çështjeje.

Këndvështrimet kryesisht liberale mbi çështjet e diskutuara më sipër nuk vlejnë edhe për disa nga çështjet më kontraverse në rrafshin e vlerave. Përfaqësuesit e PDK-së besojnë se drogat e lehta siç është marihuana nuk duhet të legalizohen. Ndryshe nga pozicioni për abortin, fenë, shtetin sekular dhe pjesërisht për martesat homoseksuale, deputetët e PDK-së në besojnë se drogat e lehta nuk duhet të liberalizohen apo të legalizohet tërësisht. Njëri nga të intervistuarit thekson se të varurit nga droga duhet të rehabilitohen dhe shërohen në institucione speciale.

PDK-ja nuk ka një qëndrim zyrtar për prostitucionin, mirëpo që të dy përfaqësuesit

besojnë prostitucioni i pakontrolluar dhe ai i asociuar me krim duhet të luftohen. Njëri nga të intervistuarit paraqet qëndrim më liberal dhe nuk e përjashton plotësisht mundësinë e legalizimit të prostitucionit si profesion nëse do të bëheshin kontrolla të rregullta mjekësore.

Qëndrimi rreth shtetit, interesit kombëtar, pakicave dhe politikave migruese shfaqin një sërë vlerash më tradicionale dhe konservative se ato që u paraqiten për çështjet e parashtruara më lartë. Të dy përfaqësuesit e PDK-së besojnë se identiteti kryesor i popullatës shumicë është ai etnik, duhe theksuar kështu se identiteti kombëtar është ai shqiptar dhe shtetësia i përket atij kosovar. Epërsia e identitetit etnik ndaj nacionalizmit shtetëror/civil është supremacia e identitetit etnik mbi atë qytetar/shtetëror sipas kësaj partie është një prej vlerave më tradicionale dhe pikërisht kjo flet për lojalitetin e PDK-së kundrejt traditës, konservimit dhe identitetit kombëtar thellësisht të mishëruar.

Derisa imigrimi ka qenë njëra ndër fenomenet më abstrakte për të cilën janë pyetur të intervistuarit, mendimet janë mëgjithatë të ndryshme. Derisa njëri nga deputetët e PDK-së thekson se ligjet të cilat rregullojnë migrimin duhet të realizohen, përfaqësuesi tjetër është më liberal dhe percepton këtë fenomen si gjë pozitive. Shembulli i dhënë nga përkrahësi i

¹⁰ Paragrafi i dytë i Nenit 24 [Barazia para Ligjit] e Kushtetutës së Kosovës thotë; "Askush nuk do të jetë i diskriminuar në bazë race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, përkatësie fetare apo përkatësie tjetër, origjine kombëtare apo sociale, orientimi seksual, lindjeje, paftësie apo ndonjë statusi tjetër personal."

politikave liberale të migrimit nënvizon rritjen e numrit të qytetarëve kinez të vendosur në Kosovë si një dukuri të cilën ai e konsideron si pozitive.

Sipas PDK-së provizionet kushtetuese duhet të jenë bazë për trajtimin e pakicave në Kosovë. Ata që të dy theksojnë se provizionet kushtetuese nuk duhet të ekzistojnë vetëm në letër por duhet të ketë zbatim praktik të tyre. Të drejtat e përmendura nga njëri prej të intervistuarve përfshijnë ruajtjen e gjuhës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, traditës, fesë, dhe karakteristikave tjera dalluese të komuniteteve dhe kulturave pakicë.

PDK nuk ka një qëndrim zyrtar lidhur me interesat kombëtare dhe se çka përfshijnë ato. Derisa njëri nga përfaqësuesit përqëndrohet më tepër në menaxhimin e burimeve natyrore dhe

kontrollimin e territorit si çështje të interesit kombëtar (përveç interesave politike), deputeti tjetër i Kuvendit përqëndrohet në ndërtimin e shtetit, sundimin e ligjit, stabilitetin, njohjen ndërkombëtare dhe angazhimin aktiv në çështjet ndërkombëtare.

Derisa për anëtarësim në parti nuk ka kushte vlerash dhe se anëtarët e rinj nuk duhet domosdoshmërisht të ndajnë vlerat e përkrahura nga partia, njëri nga të intervistuarit thekson se anëtarët e partisë duhen që të ndajnë së paku minimumin e vlerave të përkrahura nga partia. Qëndrimet dhe dallimet e tilla drejt disa prej çështjeve të mbuluara nga ky studim, tregojnë se nuk ka ndonjë sistem të qartë të vlerave në PDK dhe se vizioni i përbashkët i bazuar në vlera të qarta politike dhe sociale nuk është kusht për tu asociuar me këtë parti.

4.2. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Përfaqësuesit e intervistuar të LDK-së në këtë studim ishin Z. Lutfi Haziri, Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Z. Armend Zemaj, deputet. Të dy të intervistuarit e LDK-së theksojnë se burimi i vlerave bazë të partisë janë pikërisht rrethanat në të cilat ajo ka lindur si lëvizje. E themeluar për të kundërshtuar sistemin komunist, vlerat themelore të partisë janë pavarësia, demokracia dhe liria. Vlerat e tjera të përkrahura nga kjo parti përfshijnë

tolerancën dhe familjen si thelbin e një shoqërie të shëndoshë. Z. Haziri dhe Z. Zemaj besojnë se vlerat e gdhendura në filozofinë e LDK-së janë zhvilluar në kohën e themelimit të saj dhe rrjedhimisht janë pranuar nga anëtarët dhe udhëheqësia e saj. Për këtë shkak, këto vlera janë vazhdimësi e vizionit të presidentit të ndjerë Rugova për shoqërinë dhe aspiratat e ardhshme politike. Sipas Z. Zemaj dhe Z. Haziri, votuesit e LDK-së mund të kategorizohen në dy

grupe, votuesit besnik tradicional që i kanë të njohura vlerat e përkrahura nga kjo parti dhe votuesit të cilët pëlqejnë aspekte të caktuara të kësaj partie mirëpo që nuk janë aq të njohtuar. Pavarësisht prej kësaj, të intervistuarit besojnë se vlerat politike të LDK-së duhet të riafirmohen vazhdimisht dhe ato duhet të shërbejnë si burim i përkrahjes së elektoratit.

Për sa i përket raportit midis vlerave të partisë dhe praktikave të votimit në parlament njëri nga deputetët thekson se të dyja aspektet qëndrojnë në një linjë me njëra tjetrën dhe se të gjitha masat dhe vendimet konkrete janë të bazuara në bindjet dhe vlerat e partisë dhe ato nuk ndikohen nga bindjet personale dhe individuale të deputetëve. Kjo deklaratë nuk është edhe aq e fuqishme kur merret parasysh hezitimi i deputetit tjetër, i cili thekson se vlerat e partisë, sidomos kur flitet për votim, janë rritur dhe janë pasuruar me kohë. Një përgjigje e tillë tregon se deputetët e LDK-së jo çdo herë ndjekin grupin e vlerave të njejta kur vendosin për përkrahjen apo mospërkrahjen e politikave dhe ligjeve të caktuara.

Rëndësia e individit përballë shoqërisë si tërësi është një çështje tjetër për të cilën të intervistuarit janë deklaruar dhe kanë ndarë mendimet e tyre. Sipas tyre, individit deri më tani është kuptuar si thelbi i filozofisë së tyre, mirëpo kjo ka ndërruar viteve të fundit dhe

partia tani përpiket të promovojë kulturën kolektive (grupore). Të dy anëtarët besojnë se ky ndryshim në vlera nuk është përfunduar akoma, mirëpo angazhohen që të punojnë në këtë drejtim.

Sipas përfaqësuesve të LDK-së, të drejtat individuale dhe kolektive duhet të ushqehen në një shtet sekular ku garantohet e drejta e besimit dhe religjionit dhe ku do të mbizotëronte toleranca fetare. Sipas Z. Haziri dhe Z. Zemaj, toleranca fetare është e mishëruar thellë në kulturën dhe shoqërinë tonë dhe do të duhej të ushqehet edhe në të ardhmen. Përkundër këtij qëndrimi ndaj fesë, LDK-ja nuk e përkrahë futjen e mësimit fetar në planprogramet e sistemit të shkollave publike. Ata besojnë se në një shtet sekular siç e promovon kjo parti, feja duhet të jetë e ndarë nga të gjitha institucionet publike.

Duke përcjellur mënyrën e njejtë të argumentimit, LDK përkrah të drejtën për ndërprerje të shtatëzanisë. Të dy përfaqësuesit theksojnë se e drejta për abort forcon vlerën e familjes dhe kontribon drejt zhvillimit të normave të shëndosha morale dhe shoqërore. Megjithatë, anëtarët e Kuvendit theksojnë se një e drejtë e tillë duhet të shfrytëzohet para se embrioni të jetë zhvilluar në fetus. Duhet përmendur se njëri nga të intervistuarit e këtij hulumtimi insiston se LDK nuk i referohet kësaj

të drejte si e drejta e abortit por si e drejta për ndërprerje të hershme të shtatëzanisë. Ky dallim kualitativ është veçanërisht interesant për shkak se i referohet të kuptuarit liberal për jetën, me ç'rast individ i gëzon të drejtën e të jetuarit vetëm pasi të jetë zhvilluar në fetus dhe jo të kuptuarit konservativ se jeta fillon prej momentit të ngjizjes. Në bazë të këtij qëndrimi, deputetët e LDK-së theksojnë se kanë përkrahur ligjin për abort i cili është aprovuar nga Kuvendi.

Eutanazia është edhe një çështje e diskutueshme lidhur me të drejtën e jetës, por njëkohësisht edhe me të drejtën për vdekje dinjitoze. Derisa të intervistuarit theksojnë se nuk ekziston qëndrim i definuar i partisë për këtë dilemë, personalisht ata anojnë kah moslejimi i eutanazisë. Një qëndrim i tillë nuk është i bazuar në folozofinë dhe vlerat politike, por është i bazuar në të kuptuarit tradicional për jetën i cili është i mishëruar në kulturë. Njëri nga anëtarët e intervistuar gjithashtu thekson se e drejta për të jetuar është e drejtë e pakontestueshme që ka gjenezën në ligjin themelor të natyrës.

Qëndrimi i LDK-së për martesat midis gjinive të njejtë është pak konfuz. Derisa në një anë theksohen dhe pranohen traditat dhe vlerat e familjeve të shëndosha dhe shprehen qëndrime konservative rreth kësaj çështjeje, votimi i kushtetutës tregon një shkallë të

konsiderueshme të progresit dhe tolerancës. Të dy anëtarët e Kuvendit theksojnë kundërshtimet e tyre për martesat homoseksuale, mirëpo njëkohësisht ata shprehin përkrahjen e tyre për Kushtetutën e Kosovës, e cila nënkupton se një e drejtë e tillë duhet të garantohet. Shpjegimi logjik për këtë çështje mund të jetë ajo që kushtetuta është votuar për rëndësinë e saj simbolike dhe politike dhe kundërshtimet e partive për aspekte të caktuara të provizioneve të këtij dokumenti janë trajtuar si të nevojshme për arritjen e qëllimeve më të mëdha.

Prostitucioni është fenomen negativ i cili duhet luftuar pa kompromis. LDK konsideron se prostitucioni është pjesë e zinxhirit të krimit të organizuar dhe theksojnë se duhet aprovuar ligje strikte për të eliminuar prostitucionin. I ngjashëm është edhe qëndrimi i LDK-së për legalizimin e drogave të lehta. Sipas kësaj partie, marihuana, hashashi dhe substancat tjera të cilat në disa shtete janë shpallur të ligjshme, duhet të ndalohen dhe jo të promovohet me liberalizim konsumimi i tyre.

Dimensioni tjetër i vlerave ka të bëjë me të kuptuarit e partisë kundrejt shtetit, kombit, pakicave dhe imigracionit. Ngjajshëm me PDK-në, Lidhja Demokratike e Kosovës qëndron midis nacionalizmit etnik dhe respektimit të shtetit. Derisa identiteti primar konsiderohet të

jetë etniciteti dhe se fillimisht ata kuptojnë LDK-në si një parti etnike, ata gjithashtu theksojnë se objektiv është shteti i fortë i Kosovës. Ndarja midis identitetit kombëtar dhe atij shtetëror nuk mund të konsiderohet si çështje filozofike apo morale, por rezultat i rrethanave socio-ekonomike dhe politike në të cilat gjendet sot Kosova. Derisa në një anë, partitë theksojnë të jenë etnike dhe potencojnë lidhjet tradicionale, etnike, kulturore dhe historike me Shqipërinë, ata përpiqen për një një kulturë civile dhe identitetin e shtetit të Kosovës. Një përzjerje e tillë e ndjenjave mund t'i përshkruhet prezencës ndërkombëtare dhe presionit ndaj partive politike si dhe frikës së të qenit të etiketuar si shumë nacionaliste.

LDK nuk ka urrejtje (ksenofobi) ndaj imigrimit. Deputetët e kësaj partie besojnë se imigrimi duhet të rregullohet dhe se rregullat e njejta të imigracionit duhet të aplikohen ndaj të gjithë qytetarëve të huaj pavarësisht origjinës së tyre etnike apo kombëtare. LDK beson se rregullimi i imigrimit duhet të bëhet në bazë të motiveve të imigrantëve. Nëse analizohet në bazë të vlerave të promovuara, përfaqësuesit e LDK-së mund të karakterizohen si jo-diskriminues por mjaft të rezervuar. Ndryshe nga të kuptuarit e shoqërisë mbi individin, qëndrimi ndaj imigrimit tregon se ata favorizojnë politikat e përqëndruara në raste individuale të imigrimit më shumë se sa

grupeve të ndryshme etnike, racore apo grupeve të tjera.

Pozicioni ndaj pakicave edhe më tutje forcon vlerat metropolitane të LDK-së. Ata theksojnë se partia e tyre asnjëherë nuk ka përdorur termin pakica pasi që ata nuk bëjnë dallim midis qytetarëve të Kosovës nga grupe të ndryshme etnike apo fetare. Më tutje, njëri nga deputetët thekson se komunitetet pakicë janë pjesë e pandashme e kulturës sonë dhe ata kontribuojnë në diversitetin e shoqërisë sonë. Integrimi i komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare nga LDK perceptohet si shumë i rëndësishme.

Sipas njërit nga të intervistuarit e LDK-së, edukimi dhe përfaqësimi dinjitoz i shtetit është interes kombëtar për Kosovën. Përfaqësuesi tjetër ndan mendim të ngjashëm por nënvizon qëllimin specifik të Kosovës i cili duhet të përmbushet në të ardhmen – Integrimi Euro-Atlantik përshkruhet si interes kombëtar i rëndësishëm më të madhe dhe i cili do të mund të konsiderohet po aq i rëndësishëm sa edhe pavarësia e vendit. Një qëndrim i tillë bie në kategorinë e të kuptuarit tradicional të shtetit dhe interesave të tij dhe nënkupton se qëllimet e mëdha socio-politike të shoqërisë duhet të vendosen para interesave të individëve të saj.

Për t'u bërë anëtar i LDK-së, një qytetar i Kosovës duhet që së paku të ndajë disa vlera

themelore civile, vlera strikte morale dhe kulturore, mirëpo në asnjë mënyrë mungesa e tyre nuk do të pengonte anëtarësimin në këtë parti. Përfaqësuesit e LDK-së besojnë se individët të cilat janë të asociuar me ta do të fitojnë nga ta duke pasuruar sistemin e tyre të vlerave, duke kontribuar kështu në emancipimin civil dhe kulturor. Qëndrimet

tolerante drejt anëtarëve ekzistues apo të rinj dhe vlerave të tyre tregon se ngjashëm me PDK-në, Lidhja Demokratike e Kosovës percepton elektoratin më shumë nga një këndvështrim matematikor (numri i votave) se sa nga një pozicion i bazuar në një varg të qartë të vlerave morale.

4.3. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

Përfaqësuesit e AAK të cilët u intervistuan për këtë studim ishin Z. Ardian Gjini, Kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së dhe Znj. Gjylnaze Sylja, deputete. Sipas tyre, vlerat themelore në të cilat mbështetet AAK përfshijnë familjen, traditën, individin (më pak se familja), unitetin dhe diversitetin. Këto vlera themelore janë përcaktuar pas konsultimeve të gjata me anëtarë të partisë dhe ato paraqesin emëruesin e përbashkët të vlerave të anëtarëve të saj (dhe udhëheqësisë në nivelin qendror). Procesi i përcaktimit të orientimit të partisë përgjatë sistemit të qartë të vlerave është inicuar nga lideri i AAK-së por që është përkrahur nga e tërë kryesia. Ky proces i evolucionit të AAK-së ka zgjatur tanimë për pesë vite dhe vazhdon edhe më tutje derisa partia kërkon vizion më të qartë të vetëvetes.

Votuesit nuk janë shumë të njohur me vlerat që përfaqëson AAK. Arsyeja e përshkruar si më e rëndësishmja për këtë situatë është se deri më

tani partia nuk ka përcaktuar se cila do të ishte rruga më e mirë për ta ndjekur. Njëri nga anëtarët thekson se partia e tyre ka ndjekur një rrugë ndryshe nga partitë tjera për sa i përket komunikimit të vlerave të veta. Derisa partitë e tjera politike në Kosovë janë ngutur që të etiketojnë veten në kontekst ideologjik dhe më vonë të zhvillojnë diskutime të brendshme për atë se cilat duhet të jenë vlerat të cilat ato do t'i përkrahin, AAK fillimisht ka përcaktuar vlerat nga brenda, vlera këto të cilat do ti komunikohen publikut të gjerë. Përfaqësuesi i njejtë thekson se vlerat pas të cilave qëndron AAK do të jenë veglat më të rëndësishme për komunikim sa më efektiv me votuesit.

Sistemi i vlerave i deputetëve të AAK-së, sipas të intervistuarve mund të vërehet edhe gjatë procesit të votimit në parlament. Në shumicën e rasteve, grupi parlamentar i AAK-së voton përgjatë vlerave dhe besimit të tij, edhe pse ka pasur raste të praktikave të ndryshme. Një

shembull i dhënë nga njëri prej të intervistuarve është ai i privatizimit të kompanive publike, me ç'rast partia nuk ka qenë kundër privatizimit si koncept por ka konsideruar që momenti për zhvillimin e këtij procesi nuk është adekuat. Raste të tilla kanë qenë shumë më të pakta në numër se ato kur deputetët e AAK-së kanë përkrahur vlerat e tyre themelore dhe kanë qenë të motivuara nga arsye rrethimore dhe jo vetëm nga gjykimet morale.

Në filozofinë e AAK-së, individi është shumë i rëndësishëm dhe njëkohësisht është parakusht për një familje të shëndoshë, e cila në këtë mënyrë kontribon edhe në shoqëri. Mirëqenia e shoqërisë siç e sheh AAK varet nga individët e saj dhe se shoqëria duhet të promovojë individët e saj dhe të drejtat e tyre dhe jo anasjelltas. Megjithatë, duhet përmendur se njëri nga të intervistuarit beson në përfaqësim grupor gjatë vendimarrjes. Ky dimension tregon një karakteristikë interesante e cila nuk përmendet nga partitë tjera, me ç'rast interesat e individëve duhet të promovohen dhe të mbrohen nga grupet dhe organizatat e interesit.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës angazhohet për një shtet sekular ku feja është e ndarë nga shteti. Ata kuptojnë fenë si një çështje individuale për të gjithë qytetarët, mirëpo që nuk duhet të jetë pjesë e punëve të shtetit. AAK karakterizohet me tolerancë fetare dhe me

respektimin e ndërsjelltë ndaj pikëpamjeve dhe diversitetit fetar si dhe me përkrahjen e tyre për ushtrimin e të drejtës së besimit. Në të njëjtën temë, anëtarët e AAK-së theksojnë se nuk e përkrahin mësimin fetar nëpër shkolla publike. Njëri nga të intervistuarit në mënyrë të qartë deklaroi se në shkollat publike mund të mësohen vetëm shkencat dhe se feja mund të mësohet vetëm në shkolla fetare.

Feja nuk është baza për pozicionin e AAK ndaj abortit. Derisa të dy të intervistuarit besojnë se aborti duhet të lejohet ligjërisht në Kosovë, duhet të ketë kufinjë për sa i përket praktikimit të saj. Sipas njërit nga të intervistuarit, kufinjte e ushtrimit të ndërprerjes së hershme të shtatëzanisë nuk kanë të bëjnë me morma fetare apo etike por që kanë të bëjnë me shëndetin e gruas. Si rezultat i kësaj, pozicioni i AAK-së është i tillë që aborti duhet të lejohet nëse nuk rrezikon shëndetin dhe jetën e nënave. Duke ndjekur këtë logjikë, grupi parlamentar i AAK ka votuar në favor të ligjit të abortit në Kosovë ligj ky që është i bazuar në të drejtën e individit për të zgjedhur (nënave) dhe i cili njëkohësisht cakton kufinjë për periudhën gjatë të cilës mund të kryhet aborti.

Ndryshe nga konsensusi për abort, AAK nuk ka ndonjë qëndrim të unifikuar rreth eutanazisë. Derisa aborti dhe eutanazia kanë të bëjnë me

dilemat e njejta morale, e drejta për të dytën nuk është përkrahur nga AAK. Arsyeja pas mungesës së unitetit rreth kësaj çështjeje qëndron në atë se AAK fuqimisht përkrahë të drejtën e individit për të jetuar, edhe nëse ata individë janë të sëmurë pa shërim. Konkluzioni i nxjerrur nga qëndrimet e ndryshme ndaj abortit dhe eutanazisë është se AAK nuk e percepton të drjetën e jetës nga momenti i ngjizjes por nga momenti kur individ arrin një shkallë të caktuar të zhvillimit (transformimi nga embrioni në fetus).

Pozicioni i AAK-së për martesat midis gjinive të njejta është gjithashtu i pavarur nga çfarëdo besimi fetar. Derisa partia në përgjithësi është kundër këtij fenomeni, individë brenda partisë mund të kenë mendime të ndryshme. Është me rëndësi të përmendet se pozicioni i AAK-së ndaj martesave homoseksuale nuk është i arsyetuar nëpërmjet normave universale të sjelljes, por është i paraqitur si rezultat i të kuptuarit të tyre të familjes. Njëri nga anëtarët e AAK-së thekson këtë argument dhe arsyeton pozicionin e partisë nëpërmjet funksionit të perceptuar të familjes. Sipak tij, familja shërben për bashkimin e partnerëve të gjinive të kundërta dhe mundëson vazhdimin e familjes dhe krijimit të pasardhësve. Për AAK-në, familja është më shumë se një koncept fetar, familja është një krijim social që i shërben qëllimit të lartë

përmendur. Në këtë kuptim, martesat homoseksuale nuk i shërbejnë këtij qëllimi dhe në këtë mënyrë bëhet e panevojshme.

AAK nuk ka ndonjë pikëpamje zyrtare rreth legalizimit të drogave të lehta. Përkundër mungesës së qëndrimit zyrtar të partisë, dy anëtarët e AAK-së besojnë se drogat nuk duhet të liberalizohen. Arsyeja për një qëndrim të tillë siç u prezentua nga njëri prej të intervistuarve qëndron në mentalitetin i cili mbizotëron në Kosovë, rezultati i vetëm nga kjo do të ishte rregullimi i tregut dhe do të zvogëlohej kontrabandimi. Më tutje, ka bindjen se legalizimi i drogave të lehta do të rrisë numrin e përdoruesve të drogës dhe të ulte çmimin drogave.

Një qëndrim i tillë vlen edhe për fenomenin e prostitucionit. Derisa në parim, të dy përfaqësuesit e AAK-së besojnë se ai duhet të luftohet dhe njëkohësisht janë kundër legalizimit të tij, ata theksojnë se nuk ka ndonjë qëndrim të saktë të partisë lidhur me këtë çështje. Duke elaboruar rreth kësaj çështjeje, njëri nga të intervistuarit thekson më tutje se duke marrë parasysh rrethanat në Kosovë, ku ky lloj aktiviteti është gjysëm-legal, çdo lloj zgjidhje do të jepte rezultate më të mira. Argumenti më tutje shtjelohet se që të dyja edhe ndalimi i tërësishëm dhe rregullimi i këtij aktiviteti do të përmirësonte situatën për të mirë. Përvojat nga

shtetet e tjera përdoren si shembuj për të dy skenaret e mundshme, dhe sipas mendimit të tij përfundimet janë logjike. Nëse do të legalizohej ky aktivitet, do të ishte i kontrolluar, do të zvogëlohej rreziku për shëndet publik, trafikimi do të luftohej në mënyrë më efektive, derisa edhe ndalimi total i këtij aktiviteti do të jepte rezultate të ngjashme.

Grupi i fundit i vlerave për të cilat u deklaruan të intervistuarit e këtij studimi ishte ai i natyrës së shtetit dhe vizionit të përgjithshëm të identitetit shtetëror. Dallimi i rëndësishëm i theksuar nga AAK-ja i cili nuk është i dukshëm te partitë tjera është i natyrës semantike dhe ka të bëjë me konkurrencën e identiteteve. Anëtarët e AAK-së deklarojnë se identiteti shqiptar për ta është njësoj i rëndësishëm si ai kosovar dhe jo domosdoshmërisht këto të dyja përjashtojnë njëra tjetrën. Derisa ata konsiderojnë se kjo çështje është personale dhe varet nga ndjenjat dhe emocionet e individit, ata gjithashtu theksojnë se një konkurrencë e tillë mund të gjendet edhe në aspekte të tjera (p.sh. feja, gjinia). Një pikë tjetër e rëndësishme që u theksua nga njëri prej përfaqësuesve të AAK-së ka të bëjë me definimin e kombit. Argumenti lidhur me këtë ka të bëjë me dallimin midis nacionalizmit etnik (i lidhur me etnicitet) i cili është dominues në Kosovë dhe nacionalizmi shtetëror, një koncept më modern

i aplikuar në perëndim i cili lidh kombin me kufinj të shtetit.

Sipas përfaqësuesve të AAK-së politikat e imigracionit në Kosovë duhet të jenë liberale. Pasi që kjo çështje nuk është çështje e cila kërkon përgjigje të shpejtë (nuk është problematike), nuk ekziston ndonjë qëndrim zyrtar i partisë. Derisa ata nuk e shohin këtë çështje si problematike në afat të shkurtër (duke qenë se Kosova nuk është atraktive për imigrantë), ata besojnë se kjo duhet të rregullohet me ligj. Ngjajshëm me LDK-në dhe PDK-në, përfaqësuesit e AAK-së theksojnë se politikat e imigracionit nuk duhet të jenë të bazuara në origjinën e imigrantëve, por në llojin dhe qëllimin e imigrimit.

Sipas mendimit të AAK-së, komunitetet e pakicave duhet të trajtohen barabartë me popullatën shumicë. Derisa përfaqësimi i tyre konsiderohet shumë i rëndësishëm, ata gjithashtu theksojnë se duhet jëtë proporcional me përqindjet e sakta të tyre në shoqëri. Në këtë aspekt, AAK ka inicuar ndryshime në statutin e saj për të siguruar përfaqësim në strukturat partiake në të gjitha nivelet e hierarkisë partiake. Njëri nga të intervistuarit thekson se pakicat duhet të jenë të mbrojtura nga diskriminimet; mirëpo gjithashtu thekson se veprimi afirmativ nuk duhet të aplikohet.

Interesi kombëtar, nga anëtarët e AAK-së konsiderohet si një gjendje apo veprim (apo mungesë e një të tille) i cili përcjellë interesat e qytetarëve. Sipas njërit nga të intervistuarit, interesi kombëtar nuk duhet të kuptohet si një nocion abstrakt, por si një objektivë e cila përmirëson kualitetin e jetës së qytetarëve. Në anën tjetër, përfaqësuesi tjetër beson se çështjet të cilat duhet të trajtohen si çështje të interesit kombëtar përfshijnë funksionimin e shtetit, njohja ndërkombëtare e Kosovës, edukimi dhe zhvillimi ekonomik. Një këndvështrim i tillë aktiv për interesin kombëtar nuk është shumë i zakonshëm për partitë të cilat i takojnë spektrit të djathtë të boshtit politik. Mirëpo, një qasje e tillë mund të konsiderohet si një mënyrë pragmatike e përcaktimit të çështjeve të cilat mund të kategorizohen si çështje të interesit kombëtar.

4.4. Aleanca Kosova e Re (AKR)

Dy përfaqësuesit e AKR-së të intervistuar për këtë studim janë Kryetari i Grupit Parlamentar Z. Ibrahim Makolli, dhe Znj. Myzejene Selmani, deputete. Këta dy përfaqësues të AKR-së theksojnë se partia e tyre përkrahë të drejtat e individit si bërthamë të shoqërisë, trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët dhe meritokracinë. Këto tre vlera themelore kanë qenë baza e filozofisë së AKR-së që nga themelimi i saj. Procesi i zhvillimit të strukturës

Nuk ekzistojnë parakushte të lidhura me vlerat për anëtarësim në AAK. Derisa kjo parti nuk është e entuziazmuar të pranojë anëtarë me histori të kriminalitetit apo reputacion të keq, një person nuk duhet të ketë grup të caktuar të vlerave për t'u anëtarësuar në AAK. Ky qëndrim është arsyetuar nga Z. Gjini dhe Znj. Sylja me perceptimin e tyre të shkëmbimit të vlerave brenda partisë. Ata duket se konsiderojnë shkëmbimin e vlerave si një proces interaktiv dhe partia ofron një ambient të përshtatshëm për një shkëmbim të tillë të ideve dhe mendimeve. Përfundimisht, idetë dhe vlerat të cilat marrin më shumë përkrahje mund të pranohen, derisa ato të cilat nuk pranohen do të zbehen me kohë.

së vlerave të partisë duket se ka qenë gjithëpërfshirës në AKR dhe ka pasur për qëllim zhvillimin e një shoqërie me mundësi të barabarta me vizion të përbashkët dhe ku sundon ligji. Roli i kryetarit të partisë Z. Behxhet Pacolli perceptohet si shumë i rëndësishëm në zhvillimin e një vizioni dhe sistemi vlerash të tillë. Përkundër ekzistimit të vlerave të tilla dhe fuqie të partisë, përfaqësuesit e AKR-së janë të vetëdijshëm se

elektorati i tyre nuk është plotësisht i informuar për to. Njëri nga të intervistuarit thekson se nuk duhet konsideruar si problem për shkak se veprat flasin më shumë për vlerat se fjalët, me fjalë tjera, qytetarët do të kuptojnë shumë shpejtë se për çka qëndron AKR-ja. Të pyetur nëse merren parasysh vlerat udhëheqëse kur duhet të votohet në parlament, përfaqësuesit e AKR-së japin dy mendime të ndryshme. Në njëërën anë theksohet se vendimi për të përkrahur apo mospërkrahur një iniciativë apo politikë është një kompromis midis interesit të qytetarëve dhe programit të partisë. Përfaqësuesi tjetër, thekson se vendimet e tilla fillimisht merren nga Kryesia e Partisë dhe më pas u komunikohen deputetëve, megjithatë këta të fundit gjithmonë kanë mundësinë që të zgjedhë ndryshe nga qëndrimi zyrtar i partisë. Një aspekt që duhet përmendur është perceptimi i AKR-së për proceset e vendim-marrjes të cilat sipas tyre janë të rrjedhshme dhe fleksibile.

Individi ndodhet në zemër të filozofisë së AKR-së dhe sistemit të vlerave pasi që pa individin tërësia është e paimagjinueshme. Aktiviteti i AKR-së përqëndrohet në përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve, duke i dhënë kështu individit prioritet të padiskutueshëm ndaj grupit. Lidhja me individin bëhet edhe kur flitet për çështjet e fesë dhe rolin e saj specifik në shoqëri. Përfaqësuesit e AKR-së konsiderojnë

se feja ofron përmbushje shpirtërore për individin pasi që ky i dyti ka nevojë natyrore për të besuar në diçka. Duke promovuar besimin në Zot, AKR njëkohësisht angazhohet për tolerancë fetare dhe të drejtën e çdo individi për të shprehur dhe ushqyer besimin e tij/saj.

Përkundër qëndrimit uniform të të dy përfaqësuesve rreth fesë në përgjithësi, ata nuk pajtohen rreth përfshirjes së fesë në planprogramet e shkollave publike. Derisa njëri thekson se një alternativë e tillë nuk është e pranueshme, tjetri pohon se jo vetëm që duhet të përfshihet por që partia tanimë ka tentuar të realizojë një gjë të tillë. Arsyeja pas këtij qëndrimi është argumenti se feja ndihmon në formimin e individit dhe mishërimin e vlerave morale në karakter.

Qëndrimi ndaj abortit i përfaqësuesve të AKR-së është definitivisht më konservativ nga të gjithë. Që të dy theksojnë se janë kundër abortit në parim dhe se një gjë e tillë do të duhej të jetë e lejuar vetëm në rrethana specifike (p.sh. dhunimi) apo kur shtatëzënia rrezikon shëndetin e nënës. Pavarësisht nga pozicionimi i tyre i përbashkët rreth kësaj çështjeje, argumentet e tyre dallojnë dukshëm. Derisa njëri thotë se është kundër abortit duke theksuar se Zoti fal jetën, tjetri përdor argumentin e demografisë duke theksuar kështu se rritja natyrore e popullsisë është në

rënie dhe se abortet pa ndonjë arsye solide nuk duhet të lejohen. Për të dy, planifikimi i familjes nuk është arsye e mjaftueshme për ndërprerje të shtatëzisë. Përkundër qëndrimit konservativ ndaj abortit, anëtarët e AKR-së kanë votuar në favor të ligjit për abortin. Sipas të intervistuarve, një vendim i tillë, është marrë në bazë të mendimeve të ekspertëve, të cilët konsiderojnë se aborti deri në javën e 12 të shtatëzisë është i lejuar. Një qëndrim i ngjajshëm me atë të abortit është edhe ai për eutanazinë. Derisa të dy të intervistuarit shprehin mospajtim për legalizimin e këtij procesi ata tregojnë një dozë të konsiderueshme të keqardhjes për ata që i nënshtrohen eutanazisë. Njëri nga deputetët thekson se që të dyja opsionet janë të dhimbshme, qoftë asistimi në vdekje apo të lejohet që personi të vuaj deri në fund, por eutanazia është opsion kundër vullnetit të zotit. Deputeti tjetër konsideron eutanazinë si një gjë abnormale.

Martesa është zgjidhje personale për të gjithë individët dhe AKR nuk përkrahë apo kundërshtojë martesat e homoseksualëve. Derisa partia nuk ka qëndrim zyrtar ndaj kësaj çështjeje, ajo diskutohet brenda partisë. Njëri nga të intervistuarit shpreson që provizionet kushtetuese të cilat aktualisht përkrahin martesat midis gjinive të njejta të ndryshojnë në

të ardhmen, për shkak se ajo nuk përkrah idenë e martesave të tilla.

Prostitucioni është dukuri e cila aktualisht ndodhë në Kosovë por që nga përfaqësuesit e AKR-së konsiderohet amorale. Ata besojnë se duhet të konsiderohet i ligjshëm dhe të ndalohet. Njëri nga të intervistuarit thekson se amoraliteti i prostitucionit qëndron në faktin se i detyron njerëzit të shesin trupin e tyre. Anëtari tjetër konsideron prostitucionin njësoj si kontrabandën dhe se nuk duhet të legalizohet.

Anëtarët e AKR-së janë gjithashtu kundër legalizimit të drogave të lehta. Njëri nga ata thekson se ngjajshëm me prostitucionin, drogat janë gjithashtu pjesë e zinxhirit të krimit të organizuar dhe të trafikimit i cili dëmton familjet dhe shoqërinë në përgjithësi. Përfaqësuesi tjetër thekson se shoqëria duhet të ndërtojë mekanizma me të cilat do të luftohej përdorimi i drogave dhe hapi i parë do të ishte mospërdorimi i termit “droga të lehta”, pasi që kjo është burimi i përdorimit nga të rinjtë. Më tutje, ky anëtar sheh abuzimin e drogave si burim të rritjes së numrit të vetëvrasjeve kohët e fundit. Edhe përkundër shembujve në shtetet ku drogat e lehta janë legalizuar dhe kjo ka zvogëluar numrin e përdoruesve, anëtarët e AKR-së këmbëngulin kundër legalizimit të çfarëdo lloji të drogës.

Njësoj si partitë tjera, anëtarët e AKR-së dhanë mendimet e tyre lidhur me nocionet e shtetit dhe kombit. Derisa njëri nga anëtarët shprehet shkurtimisht dhe vetëm thekson se ne (lexo Kosovë) kemi kërkuar shtetin dhe tani duhet që të ndërtojmë identitetin shtetëror dhe vlerat, tjetri elaboron më shumë në burimin e qëndrimit të tillë. Si duket, arsyeja pas përkrahjes për krijimin e një identiteti kosovar është njëra nga dokumentët më kontraverse në historinë e fundit të Kosovës, apo e ashtuquajtura Pako e Ahtisaarit. Ajo thotë se implementimi i këtij propozimi siguron shtetësinë e Kosovës, dhe se kosovarët duhet të jenë të kujdesshëm me veprimet e tyre. Kur po flisnin për çështjen e kombit, anëtari etiketon procesin për krijimin e kombit kosovar si një proces të dhimbshëm. Pozicionimi i tillë shpalos ndjenjat e vërteta e të intervistuarit me ç'rast identiteti primar dhe besnikëria është e orientuar kah identiteti etnik.

AKR si duket është në favor të politikave të lehta të imigracionit dhe nuk tregojnë shenja urrejtjeje (ksenofobie). Arsyeja pas qëndrimit se Kosova duhet të mirëpresë të huajt të cilët kanë shprehur dëshirë për të jetuar në Kosovë shpjegohet me përvojat e hidhura të kosovarëve kur ata po mundoheshin të migrojnë në shtetet tjera. Për AKR-në, është e mjaftueshme që në të ardhmen Kosova të jetë

në gjendje të parandalojë largimin e të rinjve në shtetet tjera.

Të dy përfaqësuesit e AKR-së nuk njohin fjalën minoritet. Të dy anëtarët theksojnë se partia nuk njeh nocionin e popullit shumicë dhe minoritar por i ndan individët në qytetarë të Kosovës dhe ata që nuk janë qytetarë të Kosovës. Ky nocion i individit dhe mosnjohja e grupeve etnike apo minoritarëve qëndron në një vijë me pozicionin e AKR-së kundëjt shoqërisë si tërësi, ku shteti kuptohet si ofrues shërbimesh për individin.

Përkundër fokusit në individin, të intervistuarit e AKR-së besojnë se ka çështje të cilat mund të trajtohen si çështje me interes kombëtar. Mund të thuhet se këto dy pozicione mund të jenë paksa kontradiktore pasi që kur marrim individin si qendër të shoqërisë, është e pamundur të identifikohet interesi i përbashkët i të gjithë qytetarëve. Në të kundërtën, në rast se një vendim arsyetohet si vullnet i shumicës së qytetarëve, AKR nuk e njeh ndarjen në popullsi shumicë dhe pakicë (p.sh. sipas përkatësisë etnike). Kjo kundërthënie shkon duke u forcuar më tutje kur analizohen çështjet e interesit kombëtar të përshkruara nga përfaqësuesit e AKR-së, të cilat midis tjerash përfshijnë integrimin euro-atlantik, për të cilën përfaqësuesit e pakicave serbe shpesh kanë thënë se e kundërshtojnë.

Ngjajshëm me partitë tjera AKR nuk ka ndonjë sistem vlerash të caktuara i cili do të kushtëzonte anëtarësimin e individëve në parti. Të intervistuarit theksojnë se vlerat e

përkrahura nga AKR janë univerzale dhe liria e të shprehurit të ideve u lejon të gjithë individëve të shkëmbejnë ide dhe vlera, duke kontribuar kështu karakterin liberal të partisë.

4.5. Lidhja Demokratike e Dardanise (LDD)

Dy përfaqësuesit e LDD-së të intervistuar për këtë studim janë Z. Lulzim Zeneli, Kryetar i Grupit Parlamentar dhe ish Zëvendës Kryeministri i Kosovës z. Adem Salihaj. Këta dy përfaqësues theksojnë se vlerat të cilat mbrojnë LDD-ja janë ato të civilizimit European, dhe ato të popullit të Kosovës, ku demokracia është parimi kryesor i filozofisë Rugovianë të ushqyer në LDD. Dy përfaqësuesit nuk pajtohen në burimin e këtyre vlerave dhe me procesin e përqafimit të tyre. Përderisa njëri prej tyre thekson se programi i partisë ku janë të gdhendura vlerat themelore është i përcaktuar dhe adaptuar nga kuvendi i partisë, përfaqësuesi tjetër thekson se ky ka qenë një vendim i marrë nga kryetari i kësaj partie Z. Nexhat Daci.

Të dy deputetët besojnë se vlerat e promovuara nga partia janë shpërndarë në elektorat nëpërmjet strukturave të partisë, fushatat elektorale dhe mediave. Më tutje, njëri nga ata thekson se çdo përfaqësues i partisë paraqet një pjesë të vlerave të promovuara nga LDD-ja. Në këtë kontekst, ai thekson se profesionalizmi është një nga vlerat që LDD promovon dhe për

shkak të kësaj ekspertët sektoral janë ata të cilët çdo herë prezantojnë pozicionin e partisë në çdo sektor. Të intervistuarit gjithashtu theksojnë se të gjitha vendimet dhe votimet brenda parlamentit janë në harmoni të plotë me vlerat dhe ideologjitë e partisë.

Roli i individit krahas grupit është shumë i rëndësishëm për LDD-në pasi që të dyja janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Kjo parti mendon se nocioni i individit nuk ka kuptim pa nocionin e grupit. Megjithatë, duke i ranguar sipas rëndësisë, përfaqësuesi i LDD-së thekson se grupi si tërësi është më i rëndësishëm.

Sipas LDD-së, shteti është dhe duhet të mbetet laik. Derisa feja konsiderohet si çështje dhe zgjedhje personale dhe respektohet diversiteti fetar, ata konsiderojnë se autoritetet fetare dhe ato shtetërore duhet të qëndrojnë qartazi të ndara. Ata gjithashtu theksojnë se qëndrimet e tyre ndaj fese janë të bazuara në provizionet e Kushtetutës së Kosovës. Dukë ju referuar laicizmit, përfaqësuesit e LDD-së besojnë se religjioni nuk duhet të inkuadrohen në planprogramet e shkollave publike. Sipas njërit

nga përfaqësuesit arsyeja qëndron në diversitetin fetar në Kosovë dhe nëse lejohet mësimi fetar në institucione publike mund të shkaktohen tensione.

Edhe për abortin, dy përfaqësuesit e LDD-së ndajnë mendim laik. Që të dy theksojnë se ndërprerja e shtatëzanisë tanimë është e rregulluar me ligjin për abortin dhe se plotësisht përkrahin të drejtën e grave për të ndërprerë shtatëzaninë në fazë të hershme (siç është e përshkruar me ligj). Grupi parlamentar i LDD-së ka votuar në përkrahje të këtij ligji, përkundër paqartësive rreth periudhës se kur mund të ndërpritet shtatëzania. Për sa i përket një çështjeje tjetër të ngjashme me abortin-eutanazia, lidhur me ndërprerjen e një jete, anëtarët e LDD-së nuk e përkrahin një gjë të tillë. Argumenti i dhënë kundër këtij fenomeni është se eutanazia nuk është natyrore dhe bie ndesh me ligjet e natyrës. Është inetersant të përmendet se që të dyja si aborti ashtu edhe eutanazia kanë të bëjnë me ndërprerjen e një jete, me të vetmin ndryshim se në rastin e parë, nëna mban të drejtën për të vendosur për fëmijën e saj, ndërsa në rastin e dytë, vendimi merret nga vet pacienti i sëmurë pa shërim (vetëvrasje e asistuar), apo nga anëtarët e familjes (nëse pacienti është i pavetëdijshëm). Nga infromatat e marra nga përfaqësuesit, mbetet e paqartë pse përfaqësuesit e LDD-së trajtojnë këto dy çështje ndryshe nga njëra

tjetra, duke konsideruar njërën të natyrshme dhe të pranueshme ndërsa e kundërshtojnë tjetrën në baza të njejta (duke mos qenë e natyrshme).

Anëtarët e LDD-së janë gjithashtu kundër martesave midis personave të së njejtës gjini. Ata i konsiderojnë martesat homoseksuale si një akt jo të natyrshëm por nuk japin ndonjë koment për provizionet e Kushtetutës të cilat do të mund të interpretoheshin si në favor të martesave homoseksuale.

Prostitucioni konsideorhet si krim nga të dy përfaqësuesit e LDD-së dhe ata në asnjë mënyrë nuk do të përkrahnin ndonjë iniciativë e cila do të legalizonte atë. Një mendim të ngjashëm mosmiratimi, perfaqësuesit e LDD-së japin edhe për mundësinë e legalizimit të drogave të lehta. Në të dyja rastet, ata nuk besojnë se legalizimi i këtyre aktiviteteve do të zvogëlonte numrin e shfrytëzuesve (të shërbimeve seksuale apo të drogës). Ata besojnë se duhet përdorur forma të tjera për të luftuar këto dy fenomene negative.

Anëtarët e LDD-së bëjnë një dallim të qartë në mes identitetit kosovar dhe atij shqiptar. Derisa e dyta konsiderohet identiteti primar për shumicën e popullsisë, ata gjithashtu theksojnë se identiteti kosovar është gjithashtu shumë i rëndësishëm dhe identiteti i vetëm të cilin duhet promovuar në arenën ndërkombëtare.

Identiteti shtetëror/civil është mbështetur me përkrahjen prej 90% të qytetarëve të Kosovës për krijimin e shtetit. Sipas mendimit të njërit nga anëtarët, mohimi i identitetit kosovar do të thotë mohimi i shtetit aq shumë të dëshiruar.

Shteti i Kosovës në vizionin e përfaqësuesve të LDD-së duhet të ketë politika strikte të imigracionit. Derisa njëri prej tyre thekson se ligjet e imigracionit duhet të jenë të ngjashme me ato të shteteve Europiane, tjetri thekson se duke qenë shtet në zhvillim, imigracioni i pakontrolluar dhe i pakufizuar mund të shkaktojë probleme të konsiderueshme. Megjithatë duhet theksuar se të dy të intervistuarit besojnë se politikat e imigracionit duhet të jenë jo-diskriminuese ndaj disa shteteve dhe kombeve.

LDD-ja mban qëndrimi jo-diskriminues edhe ndaj çështjes së pakicave që jetojnë në Kosovë. Sipas tyre, pakicat nuk duhet të trajtohen si të tilla, por si qytetarë të Kosovës. LDD beson se pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike, fetare

apo racore, komunitetet duhet të trajtohen njësoj nga ligji dhe duhet të gëzojnë mundësitë e njëjta si popullata shumicë. Më tutje, njëri nga anëtarët e LDD-së, thekson se trajtimi dhe të drejtat e komuniteteve duhet të bazohen në normat dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht. Duhet përmendur, se ndryshe nga partitë e tjera, LDD-ja nuk përkrah veprimin afirmativ për minoritetet.

Njësoj sikurse edhe partitë e tjera, LDD konsideron se ekziston interesi kombëtar dhe se interesat kombëtare të Kosovës kanë të bëjnë me njohjen e pavarësisë së vendit, anëtarësimi në KB dhe organizatat tjera ndërkombëtare, kontrolli efektiv i territorit dhe sovraniteti i plotë, zhvillim ekonomik dhe çështje tjera të natyrë së njëjtë.

Vlerat nuk janë kusht për tu anëtarësuar në LDD. Mirëpo të dy të intervistuarit theksojnë se mirëpresin individët të cilët ndajnë vlerat e njëjta me partinë.

4.6. Partia Social Demokrate e Kosovës (PSD)

Përfaqësuesja e vetme e PSD-së e intervistuar për këtë studim është ish liderja e partisë Znj. Kaqusha Jashari, e cila është njëherit edhe deputetja e vetme e kësaj partie në Kuvendin e

Kosovës.¹¹ Znj. Jashari deklaroi se vlerat thelbësore të PSD-së janë barazia, solidariteti, liria e lëvizjes dhe e fjalës, të drejtat e njeriut ku

¹¹Duhet të theksohet se Znj. Jashari është zyrtarisht anëtare e grupit parlamentar të PDK-së pasi që në zgjedhjet e fundit PSD bashkoi forcat me PDK-në përmes një koalicioni parazgjedhor.

duhet të veçohen të drejtat e punëtorëve dhe bizneseve të vogla. Këto vlera janë shëndrruar në parimet bazë të partisë përmes një procesi të gjatë të zhvillimit të partisë ku ka marrë pjesë anëtarësia e gjerë. Edhe pse vendimi përfundimtar është marrë nga kryesia e partisë, vlerat janë zhvilluar si rezultat i një procesi gjithëpërfshirës. Njohuria e votuesve për vlerat e mishëruara në filozofinë e PSD-së nuk është në nivel të kënaqshëm dhe shpesh kufizohet në dijeninë që PSD është parti me orientim të majtë. Sipas PSD-së, kjo ka ndodhur për shkak të procesit të pavarësisë, që e ka penguar diskutimin mbi shumë çështje të tjera, por tanimë që statusi është përmbyllur, PSD beson se partia mund të fillojë punën për promovimin e identitetit dhe vlerave të veta. Votimi i saj në Kuvend jo gjithmonë ka qenë i bazuar në vlerat që mbrohen nga kjo parti. Znj. Jashari beson se dialogu i brendshëm duhet të intensifikohet dhe se duhet të mbahet një qëndrim më i fortë kundrejt pensioneve, ligjit të punës dhe shëndetësisë.

Partia Social Demokrate vendos fokusin e vet tek shoqëria e cila konsiderohet të ketë prioritet më të lartë se sa individ. Mirëpo, duhet të theksohet që tek PSD besojnë se është shteti ai që duhet të vlerësojë individin. Ky pozicion është mjaft i ndryshëm nga ai i partive të tjera të intervistuar gjatë studimit dhe PSD është partia e vetme që vendosë grupin më lartë se

individin. Një qasje e tillë nuk është e jashtëzakonshme dhe është në përputhshmëri të plotë me perceptimet tradicionale socialdemokrate mbi relacionet në mes të individit dhe shoqërisë. Në bazë të këtyre perceptimeve, individi vështrohet vetëm si pjesëtar i grupit.

Sipas PSD-së, liria e praktikimit të fesë është e drejtë e pacënueshme e çdo individ. Kjo liri është pjesë e vlerave të barazisë, sipas së cilës, gjithësecili ka të drejtë të besojë në atë cfarë dëshiron të besojë. Toleranca fetare gjithashtu promovohet nga PSD. Në harmoni me këtë qëndrim, përfaqësuesja e PSD-së argumenton që nuk ka kuptim të përfshihet një çështje e natyrës personale (religjioni) në planprogramet mësimore të shkollave publike. Për më tepër, përfshirja e religjionit mund të ketë pasoja negative për shkak të diversitetit fetar në Kosovë. Ata të cilët duan të ndjekin mësimet fetare do të duhej sipas përfaqësueses së PSD-së të drejtohen në institucionet fetare.

Parimisht, PSD nuk është kundër të drejtës për ndërprerje të parakohëshme të shtatëzënisë. Kjo parti do të mbështeste një ligj që do të lejonte abortin, por nuk ka votuar pro ligjit të miratuar në Kuvendin e Kosovës. Arsyeja për mos-votimin e ligjit për abortin është e natyrës teknike dhe ka të bëjë me definicionet e

përfshira në këtë ligj si dhe me afatet kohore brenda të cilave aborti mund të kryhet.

Eutanazia konsiderohet si process jo human nga ana e PSD-së. Përkundër faktit që mbajtja e njerëzve gjallë përmes aparaturave i kushton shumë sistemit shëndetësor në Kosovë, përfaqësuesja e PSD-së shprehet se partia e saj është kategorikisht kundër eutanazisë. Një paralele e ngjajshme me atë të LDD-së mund të tërhiqet edhe në rastin e PSD-së dhe qëndrimin të saj kundrejt abortit dhe eutanazisë, ku ndërprerja e një jete të ardhshme është e pranueshme, ndërsa ndërprerja e jetës së një personi pa gjasa për përmirësim konsiderohet jo humane. Përsëri, konkluzioni i vetëm që mund të ofrojë shpjegim për qëndrime të tilla kontradiktore është përceptimi mbi atë se kur fillon jeta.

Martesa e personave të gjinisë së njëjtë nuk është diskutuar në parti dhe PSD nuk ka qëndrim zyrtar rreth kësaj çështjeje. Përfaqësuesja e PSD-së nuk dëshironte të ofrojë qëndrim qoftë edhe personal rreth asaj se çfarë do të jetë pozicioni i partisë së saj mbi këtë çështje në të ardhmen. Ndryshe nga rasti i martesës së personave të gjinisë së njëjtë, PSD ka një qëndrim zyrtar rreth mundësisë së legalizimit të drogave të lehta. Ata besojnë se drogat shkaktojnë vetëm dëme për shoqërinë dhe se legalizimi i tyre nuk mund të sillte asgjë

të mirë. Përkundrazi, kjo parti beson se rinia, si pjesa më e ndikuar e popullatës nga ky fenomen duhet të orientohet nga aktivitetet sociale dhe sportet, nga të cilat edhe mund të përfitojnë.

Prostitucioni perceptohet nga PSD si aktivitet shumë degradues. Ata do të dëshironin të ç'rrenjosin këtë fenomen dhe besojnë që mundësia e vetme për ta bërë këtë është ngritja e standardit të jetesës. Përderisa tek një pjesë e madhe e popullatës mbretëron varfëria, PSD beson se nuk mund të ketë masa efektive për të luftuar këtë fenomen.

Identiteti kosovar dhe ai shqiptar nuk janë paradigma që garojnë në mes vete sipas PSD-së. Ata e shohin elementin shqiptar si me shumë ndikim, por jo domosdoshmërisht të jetë në garë me identitetin kosovar. Përfaqësuesja e PSD-së beson se kjo çështje është e lidhur ngushtë me mentalitetin dhe kulturën e njerëzve dhe se nuk ka të bëjë me konceptet e kombit dhe nacionalizmit. Në një shtet të tillë të Kosovës, PSD tejkalon përceptimet tradicionale për të huajt dhe beson se hapja ndaj kulturave të tjera në fakt do të ishte shumë e mirë për Kosovën pasi që do të përforconte lidhjet me ato kultura. Përkundër faktit se social demokratët janë në favor të një diversiteti kulturor, ata nuk mbështesin veprimin afirmativ në favor të pakicave etnike. Ata mbështesin

fuqimisht trajtimin e barabartë të pakicave dhe realizimin e të drejtave të tyre kulturore si dhe ato për shkollim në gjuhë amëtare, ata nuk pranojnë shkejljen e të drejtave të shumicës si mënyrë për të arriturur këtë.

PSD beson se interesi kombëtar ekziston dhe se çështjet me interes kombëtar për Kosovën janë krijimi i shtetit funksional dhe njohja ndërkombëtare e këtij shteti. Është interesant të ceket që PSD beson se njohja ndërkombëtare mund të arrihet duke u promovuar

funksionaliteti, gjegjësisht, do të duhej të synohej një shtet stabil dhe plotësisht funksional që e meriton njohjen.

Ndryshe nga partitë e tjera të intervistuar, përfaqësuesja e PSD-së beson se vetëm qytetarët ose votuesit që ndajnë vlerat e partisë do të duhej t'i bashkangjiten asaj. Ajo beson se kushdo që e konsideron anëtarësimin në këtë parti do të duhej së pari të lexojë dhe analizojë programin e saj.

5. KONKLUZION

Ngjajshëm si me dimensionet e tjera të analizuara në dy raportet paraprake, partitë politike në Kosovë nuk kanë një sistem të definuar mirë të vlerave që është në harmoni me ideologjitë e tyre të proklamuar. Një fenomen tjetër që vlen të përmendet dhe që do të duhej të konsiderohej si mjaft problematik është se partitë në Kosovë nuk kanë lidhje të ngushta me vlerat. Një qasje e tillë instrumentale apo kuazi-mbështetja e partive që shpesh kufizohet me deklarata publike dhe retorikë është mjaft e rrezikshme pasi që mund të shpiejë drejt mos-aprovimit nga ana e elektoratit dhe drejt një devalvimi të politikës.

Mund të thuhet se hezitimi i partive politike për të përqafuar një sistem të qartë të vlerave dhe veprimi në bazë të tyre shkaktohet nga mungesa e debatit për çështje kontraverse si dhe pasiguria e partive rreth reagimit të mundshëm të elektoratit në rast se ato do të deklararin publikisht bazën e vlerave. Për më tepër, kundërthëniet e shpeshta në mes të përfaqësuesve nga e njejta parti, vërtetojnë mungesën e theksuar të debatit përbrenda partive rreth çështjeve që ndikojnë shoqërinë dhe normat morale të saj.

Shumica e qëndrimeve të partive kundrejt çështjeve të adresuara në këtë raport janë më

afër asaj që mund të konsiderohet si më tradicionale dhe konservatore. Arsyeja për pozicionim të tillë është mentaliteti i perceptuar konservativ tek popullata e përgjithshme dhe partitë nuk dëshirojnë të rrezikojnë distancimin nga votuesit. Si rezultat i konservatorizmit tek partitë politike në Kosovë, votuesit e rinjë që gjithashtu përbëjnë grupmoshën më të madhe të votuesve mund të krijojnë aversion ndaj partive politike dhe politikës në përgjithësi, duke qëndruar kështu jashtë skenës politike dhe shpesh duke mos dalë as në votime. Vlen të theksohet se jo të gjitha grupet shoqërore ndajnë vlerat e njejta me prioritetet, programet dhe pozicionet e partive ndaj çështjeve të adresuara në këtë raport por edhe në dy raportet e tjera, andaj edhe një pjesë e konsiderueshme e elektoratit mbetet e 'painkuadruar'. Segmenti më progresiv i shoqërisë nuk ka alternativë votimi dhe se kjo do të duhej të shikohej nga partitë politike si mundësi për të rritur bazën e mbështetësve.

Një vërejtje përfundimtare në këtë analizë do të duhej të ishte vlerësimi se jo vetëm partitë duhet të fajësohen për mungesën e diskutimit rreth temave të rëndësishme që janë me interes për publikun. Media në Kosovë kanë qenë mjaft jo-efektive në gjenerimin e një

debati të tillë dhe si rezultat shumë tema mbeten tabu për shoqërinë. Për më tepër, si pasojë e kësaj qetësie shumë fenomene shoqërore nuk adresohen, duke krijuar kështu mundësinë për probleme më të mëdha në të ardhmen. Nëse Kosova do të zhvillojë një shoqëri demokratike siç proklamohet shpesh nga politikanët, ajo shoqëri duhet të bazohet

fuqishëm në vlera të cilat sfidohen vazhdimisht nga debati dhe shqyrtimet. Mungesa e debatit rreth këtyre çështjeve e rritë zbrastësinë në mes të shoqërisë kosovare dhe shoqërive që ne aspirojmë t’ju bashkohemi (lexo BE) dhe forcon mentalitetin e prapambetur që është prezent tek një pjesë e konsiderueshme e populates së shtetit më të ri në Europë.

SHTOJCA 1: LISTA E TË INTERVISTUARVE

#	Emri	Grupi Parlamentar
1.	Xhavit Haliti	Deputet i PDK-së dhe Anëtar i Kryesisë së Kuvendit
2.	Memli Krasniqi	Deputet i PDK-së
3.	Kaqusha Jashari	Deputet i PSD-së (në listën e deputetëve të PDK-së)
4.	Lutfi Haziri	Shef i Grupit Parlamentar të LDK-së
5.	Armend Zemaj	Deputet i LDK-së
6.	Ardian Gjini	Shef i Grupit Parlamentar të AAK-së
7.	Gjylnaze Syla	Deputet i AAK-së
8.	Lulzim Zeneli	Shef i Grupit Parlamentar të LDD-së
9.	Adem Salihaj	Deputet i LDD-së
10.	Ibrahim Makolli	Shef i Grupit Parlamentar të AKR-së
11	Myzejene Selmani	Deputet i AKR-së

SHTOJCA 2: BIBLIOGRAFIA

Berlin, Isaiah (1969). *Katër Ese mbi Lirinë*. Oxford University Press.

Crain W.C, Teoritë e Zhvillimit, Kapitulli VII. "Format e Kohlbergut mbi Zhvillimin Moral" pp-118-136, Prentice-Hall, 1985

Jones, M. Jeffry. Disa Amerikanë Hezitojnë të Votojnë për Mormonë, Kandidatët Presidential 72-Vjeçarë. Artikull që gjendet në faqen e internetit: <http://www.gallup.com/poll/26611/Some-Americans-Reluctant-Vote-Mormon-72YearOld-Presidential-Candidates.aspx>.

Kushtetuta e Kosovës. Gjendet në faqen e internetit: [ëëë.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)

Rorty, Richard. "Demokracia dhe Filozofia": Ligjerata gjendet në faqen e internetit: <http://www.eurozine.com/articles/2007-06-11-rorty-en.html>.

Shwartz, Shalom. "Prioritetet e Vlerave dhe Sjellja: Zbatimi i Teorisë për Sistemin e Integruar të Vlerave". Kapitull në librin: "Psikologjia dhe Vlerat". Edituar nga Clive Seligman, James Olson dhe Mark P. Zanna. Routledge, 1996

Sturgis, Patrick. "Afërsia me Parti dhe Ndryshimi i Vlerave Themelore Politike" – Këshilli Hulumtues Ekonomik dhe Social, Dokument Pune nr. 5

Sturgis, Patrick. "Shkaqet dhe Pasojat e Vlerave Politike Bazë" – Punim i prezantuar në takimin vjetor të Shoqatës Amerikane për Shkenca Politike. 27 gusht, 2003